ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues BUJAR HUDHRI
Kryeredaktore VIOLETA MURATI

E SHTUNË, 27 KORRIK 2019. NUMËR 37. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Shkrimtar, publicist, politikan i njohur shqiptar, themelues i së përditshmes më të lexuar në Kosovë, "Koha ditore", Veton Surroi tregon se çfarë po ndodh mes dy vendeve tona, Kosovë e Shqipëri; Surroi ka mendimin e tij kritik për dimensionin e lirisë dhe komunikimin mes dy shoqërive, kur thotë se e vetmja gjë që i ndan shqiptarët nga njëri tjetri janë ata vetë, kufijtë mendorë që i kanë vënë vetes, ndërsa ajo që i bashkon është se gjenerojnë gjithnjë e më pak shpresë...

VETON SURROI: Shqiptarët sot bashkohen, si emigrantë, në Londër e Stokholm dhe Cyrih e Nju-Jork



Portreti nga Ina Lajthia

(fq. 2-4)

FORUM MBI PËRKTHIMIN

PËRKTHIMI – HEQJE DORË NGA ËNDRRA E PËRSOSMËRISË

nga Mimoza Hysa

(fq. 5)

FILLIMET E LETËRSISË SË SHEK. XX

PRIRJET E STUDIMIT TË TEKSTEVE DHE AUTORËVE NË BOTIMET SHKOLLORE SHQIPTARE

nga Evalda PACI

(fq. 6)

BISEDË ME DJALLIN

Rexhep Ferri

(fq. 11)

ESE

PATËR SHTJEFNI

nga Hyjni Ceka

(fq. 10)

Besnik Mustafaj nderohet me çmimin prestigjioz "Flaiano Literary" në Itali (fq. 13)

Vlashent Sata: muzikë, gojëdhëna dhe shëtitje në Zâ Fest III, në Theth (fq. 12)

Festivali PriFest: Irena Cahani dhe Arben Bajraktaraj, aktorja dhe aktori më i mirë (fq. 13)

KADARE NË LISTËN E FINALISTËVE PËR ÇMIMIN NDËRKOMBËTAR LETRAR NEUSTADT PËR VITIN 2020

JONATHAN FRANZEN: S'do të doja të shkruaja gjëra që s'janë letërsi

Intervistoi: Isaac Chotiner

SINKRON DIHATJESH

Dom Gjergj Meta

BIBLIOTEKË

SI PIKË UJI E AVULLUAR

Delvina Kërluku

Shkrimtar, publicist, politikan i njohur shqiptar, themelues i së përditshmes më të lexuar në Kosovë, "Koha ditore", Veton Surroi tregon se çfarë po ndodh mes dy vendeve tona, Kosovë e Shqipëri; Surroi ka mendimin e tij kritik për dimensionin e lirisë dhe komunikimin mes dy shoqërive, kur thotë se e vetmja gjë që i ndan shqiptarët nga njëri tjetri janë ata vetë, kufijtë mendorë që i kanë vënë vetes, ndërsa ajo që i bashkon është se gjenerojnë gjithnjë e më pak shpresë...

Veton Surroi: Shqiptarët sot bashkohen, si emigrantë, në Londër e Stokholm dhe Cyrih e Nju-Jork

Intervistoi: Violeta Murati

Janë disa personazhe, intelektualë, ashtu sikurse ju, për t'ju marrë veçmas nga politika e për të ndërtuar një diskurs kulturor. Duket privilegj a luks, por në të vërtetë ç'janë këto raporte që përherë e më shumë në mjediset tona kaq paradoksale nuk komunikojnë mes tyre? Sa është e keqkuptuar kultura nga politika, sidomos për shtete të vogla si tonat?

Nuk besoj se ka kufi mes kulturës dhe politikës. Politika kërkon një kontekst kulturor për ta shprehur veten, në demokraci, diktaturë apo çfarëdo të qëndrojë në mes. Anasjelltas, kultura zhvillohet në një kontekst social, pra edhe politik. Aty ku ekziston kufiri, natyrisht, është te banaliteti, qoftë politik ashtu edhe kulturor, por kjo është një temë tjetër që kërkon më shumë shpjegim, një temë më vete.

Si është të jetosh në një shtet të sapokrijuar, pas një periudhe të gjatë konflikti?

Për një njeri i cili ka dhënë kontribut që ky shtet të krijohet është një dramë e përditshme. Është si ta shohësh një fëmijë të rrëzohet e të lëndohet dhe sërish të nesërmen, në të njëjtin vend bën të njëjtin gabim, rrëzohet dhe lëndohet. Përgjatë dhjetë vjetëve, një elitë e kriminalizuar e mban peng këtë fëmijë dhe e detyron çdo ditë të bëjë të njëjtin rrugëtim, të rrëzuarit dhe të lënduarit. Është një sadizëm i paparë.

Ju keni zgjedhur dyshtetësinë, si ndiheni?

Ndihem natyrshëm. Në të dyja shtetet jam në shtëpi dhe në të dyja shtetet ndihem i izoluar prej shtetit. Kam kënaqësinë e përputhjes së identitetit tim me simbolet e tij. Kam një oqean të tërë të panjohurash për të eksploruar brenda shteteve shqiptare. Kam shumë lumturi për këtë mundësi dhe kam gjithashtu pikëllim për mënyrën se si shqiptarët vetëpengohen që të ecin drejt vlerave të një qytetërimi, habitati i tyre i natyrshëm europian.

Vini nga një familje me kulturë, babai juaj ka qenë ambasador, fillimisht gazetar dhe shkrimtar, me nënën etnologe... Çfarë ka krijuar te ju, qysh nga fëmijëria, ky mjedis?

Ky mjedis më ka joshur që të shtroj pyetje, që çdo gjë të jetë e nënshtrueshme e pyetjes, që të mos ketë të vërteta absolute. Rrjedhimisht, do ndërtuar e vërteta nga burime të ndryshme: artikuj gazetash, përralla, motive të veshjes kombëtare, lajme televizive, filma të animuar, romane, ecje nëpër male dhe vështrime të natyrës...

Si janë bërë te ju gazetari, shkrimtari e politikani? Në fakt, profili juaj më kujton vitet '30 kur një shkrimtar mbante "detyra" politike, atdhetare e kulturore për vendin. Thjesht, tani s'ndajmë besoj të njëjtat rrethana, por na duket sikur s'kemi ndryshuar në këtë distancë 100-vjeçare... pse krijohet kjo figurë komplekse këtu?

U përputhën shumë gjëra njëkohësisht. Zhbërja e ish-Jugosllavisë, rënia e Murit të Berlinit, okupimi ushtarak e policor i Serbisë në Kosovë – që të gjitha këto u zhvilluan brenda një viti. Dhe për to duhej dhënë përgjigje. Çdokush prej nesh, që ishim gazetarë, shkrimtarë a veprimtarë kulture, që besonte se mund të jepte një kontribut, këtë e bënte pa ftesë e pa pritje që të vinte në radhë.

Ky rrugëtim më shtyu të mendoja edhe më thellë për dimensionet e lirisë që kërkonim. Nuk kishim

> *Për një njeri i cili ka dhënë kontribut që ky shtet të krijohet është një dramë e përditshme. Është si ta shohësh një fëmijë të rrëzohet e të lëndohet dhe sërish të nesërmen, në të njëjtin vend bën të njëjtin gabim, rrëzohet dhe lëndohet.*

të bënim vetëm me lirinë kolektive të shqiptarëve nga okupatori serb, por edhe me liritë e një shoqërie që ndërtohej si demokraci e ardhshme. Pra, edhe një shoqëri që si bosht të saj duhej ta kishte shtypin e lirë, mendimin kritik, madje mendimin kritik të brendshëm edhe në kushtet e pushtimit. Këto do të ishin sfida të jashtëzakonshme për popuj edhe më të emancipuar se shqiptarët e Kosovës.

Shkojmë 22 vjet më parë, ndalemi tek web-i i gazetës "Koha ditore", në këtë fillimteksti: "Shqiptarët e pushtuar po lexonin një gazetë të lirë në mëngjesin e 31 marsit 1997 gjithandej Kosovës. Paqes së brishtë po i vinte era luftë. Së pari, duhej ta vrisje frikën brenda vetes..." Ç'ishte kjo histori, themelimi i një medie nga ju, në këto kushte. Mund të na rikujtoni diçka mbresëlënëse, çfarë rëndësie historike ka?
Të themelosh një gazetë të pavarur në një territor të pushtuar tingëllon sot si çmenduri. Ashtu duhej të ishte edhe atëherë. Por, ishte një kthesë prej atyre që kisha insistuar që të bëheshin që nga viti 1989, që ta fitonim lirinë tonë kolektive duke u çliruar fillimisht nga brenda. Dhe për ta bërë këtë, një gazetë si "KOHA Ditore" tregonte pjekurinë historike të një shoqërie që ecën drejt lirisë.

Letërsia besoj është "e fshehta" juaj, që po t'ju pyesnim se ç'vend zë, pa dyshim do të keni një të vërtetë të mjaftueshme, pse shkruani, apo jo?
Jeta është rrëfim dhe ne në të, si individë dhe si shoqëri, jemi rrëfimtarë të saj. Ne jetojmë sepse rrëfejmë; pa rrëfim ekzistenca jonë do të kalonte e paidentifikuar, nuk do të ishte. Letërsia për mua, shikuar kështu, është të jetuarit estetik.

"Fshehtësia e zbulimit të Hanës" është shpallur më i shitur në Panairin e Librit sivjet. Në fakt, në Prishtinë vëmë re se librat tuaj gjithmonë marrin vëmendjen e medias, po në raport me Tiranën si e shikoni këtë? Dalim për pak edhe më përtej se libri juaj... Refuzim për njohje apo arrogancë?
Është një fenomen që kërkon më shumë studim, por në thelb duket të kemi të bëjmë me një relacion kulturor njëkahësh, së paku kur bëhet fjalë për letërsinë. Aty ka gjithçka, edhe paragjykim, rrjedhimisht mosnjohje, por edhe mosgatishmëri për të menduar tej kufijve të vendosur më herët.

Por, në thelb, kemi të bëjmë me një proces të ri historik i cili zhvillohet që nga rënia e diktaturës në Shqipëri. Qytetarët e saj filluan të zbulojnë çdo gjë, fillimisht qytetet brenda Shqipërisë që nuk kishin mundur të vizitonin, pastaj edhe çdo gjë që ishte jashtë kufijve të shtetit. Përgjatë gati tre dhjetëvjetëshve zhvillohet një sfidë identitare, krahas të kuptuarit se termi "shqiptar" nuk ka të bëjë, siç përdoret rëndom, me të qenët shtetas i Shqipërisë, por është përcaktim identitar kombëtar. Kosova dhe shoqëritë e tjera shqiptare janë ende pjesë e zbulimit të Shqipërisë së mbyllur.

Pse kjo marrëdhënie kaq e cunguar e informacionit, çfarë nuk shkon në këtë komunikim mes "nesh"? Nuk ka një gazetë të Kosovës në tregun e medias në Shqipëri dhe anasjelltas. A jemi në kohën e duhur për ta hequr këtë mur, si mund të bëhet?
Nuk ekziston muri mes shqiptarëve. Muret ideologjike janë shembur. Edhe gjeografia ka ndryshuar; Prishtina është më afër Tiranës sesa Saranda. E vetmja gjë që i ndan shqiptarët janë ata vetë, kufijtë mendorë që i kanë vënë vetes. Ajo që i bashkon shoqëritë shqiptare është se gjenerojnë gjithnjë e më pak shpresë. Shqiptarët sot bashkohen, si emigrantë, në Londër e Stokholm dhe Cyrih e Nju-Jork. Një herë të ikur nga vendet e tyre, fillojnë ta njohin njëri-tjetrin.

Një tjetër histori juaja letrare, libri "The Macchiato Cow" (Lopa e macchiatos) është një histori personale, e shkruar me ironi dhe humor dhe në mënyrë që të ngjallë kureshtje, që trajton konceptet e identitetit dhe shtetësisë nëpërmjet historisë së familjes së Surroit – dhe pasaportës së tij. Pse nevoja e këtij argumenti sa historik, filozofik e politik?
"Lopa e Macchiatos" është ndoshta libri im më ambicioz. Është një aventurë që fillon me familjen time, anët kundërshtare ideologjike shqiptare që kishin ambicien që Kosova të ishte pjesë e Shqipërisë dhe që duke dështuar, krijuan aksidentalisht Kosovën si entitet politik. Por ky rrugëtim vazhdon në shumë fusha të tjera, prej etologjisë njerëzore (pra trashëgimisë shtazore te njerëzit) te koncepti i "komuniteteve imagjinare" (pra kombeve), gjuhës sakrale dhe asaj popullore, Paqes së përhershme të Imanuel Kantit e deri te Plani Marshall që ndërtoi Bashkimin Europian...

Kur ka qenë për ju ajo që quhet "jetë e stuhishme", pra në një gjendje të jashtëzakonshme?
Kur përfundova studimet në Meksikë, më 1982, u ktheva në Prishtinë. Ishte gjendje e jashtëzakonshme, me policë veshur me jelekë antiplumb, helmeta dhe kallashnikovë në duar, duke patrulluar qytetin. Prej atëherë nuk besoj të kemi përjetuar një jetë të zakonshme.

Ju jeni personi i përshtatshëm për njohjen dhe staturën tuaj, kontributin, mendoj se keni një përgjigje se çfarë do të mendonit se do të jetë vlera më e madhe për Kosovën dhe për Shqipërinë? Si i përjetoni dramat e shoqërive tona?
Vlera më e madhe do të jetë kur elitat e vendit, – politike, intelektuale dhe ekonomike – të vihen në përpjekje për ta ndërtuar identitetin kombëtar dhe identitetet shtetërore europiane dhe bashkëkohore, një identitet që nuk do të jetë përpjekje për të qenë si kombet e tjera, por të qenët si kombi që duhej të ishim në tokën tonë, europiane.

Çfarë identifikoni të fuqishme nga Kosova në raport me Shqipërinë, si përplotësuese të njëra-tjetrës... shpesh përpiqen të na fusin në debatet e dy identiteteve. Si mendoni, a mund të ekzistojë sot një diskurs i tillë?
Kemi të bëjmë me një përpjekje për ta gjetur veten pas shembjes së komunizmit. Ende po bëhet përpjekja për ta shndërruar në kuptim faktin se ndër ne, shqiptarët, ekziston një pluralizëm apo një pluricentrizëm. Pra, nuk ekziston një qendër shqiptare, nuk ekziston "trade mark" për shqiptarizëm. Kjo është një vlerë e cila do të kërkojë hapësirën e vet politike, intelektuale, kulturore... Dhe, si rezistencë ndaj saj, do të vazhdohet të insistohet për një qendër kulturore shqiptare apo për shpikjen e identitetit kosovar që qenka i ndryshëm prej atij shqiptar.

Për Kosovën shumë artikulojnë se liria e fituar ishte e pamjaftueshme. Ju si e keni përjetuar dhe perceptuar? Edhe ne çalojmë te ky mendim për lirinë, "të fituar" pas rënies së komunizmit.
Liria për nga natyra nuk është e mjaftueshme. Ajo, apo ato, pra liritë, janë aty për t'u zgjeruar, për të shtyrë pragun, kufijtë. Kosova, për fat të keq, lejoi që çlirimin prej okupatorit serb ta zëvendësojë me kufizim të lirive personale e kombëtare nga ana e kapësve të shtetit, uzurpatorëve shqiptarë.

Keni thënë se shoqëria shqiptare, e Shqipërisë, ka jetuar në gri, duke e parë si një provokim estetik. Nga vjen ky mendim, çfarë ka ndikuar? Ju lutem, mos na e bëni politike përgjigjen, nëse mund të arrihet nga ju?
Socializmi në Shqipëri, pos dhunimeve të tjera, ka qenë dhunues estetik. Dhe dhunimi u manifestua në uniformitetin e qyteteve e fshatrave, në ngjyrën gri të godinave, në zymtësinë e ndërtimit. Thyerja e këtij koncepti nga ana kryebashkiakut Edi Rama në Tiranë me ngjyra të ndezura, që për disa ishte kiç, qe një provokim estetik, madje një provokim i nevojshëm për të zgjuar shqisat e shoqërisë.

A mund të kemi prej jush cili është identikiti i pushtetarit shqiptar sot? Sigurisht, referuar edhe marrëdhënies që ndërtojnë me kulturën, me intelektualët, me vetë shtetin?
Nuk besoj të ketë një profil të përgjithshëm të pushtetarit shqiptar. Madje nuk besoj në përshkrim kolektiv që do t'i përshtatej secilit veç e veç, kujtdo qoftë. Nuk besoj në idenë se furrtari italian, rrobaqepësi tajlandez dhe piloti bangladeshas kanë profil të aplikueshëm kolektiv; rrjedhimisht, nuk e ka as pushtetari shqiptar.

Cilat janë modelet e politikanit që ju keni, si underground historik? A kemi ne një trashëgimi të denjë historike në politikë, sepse shpesh na duket sikur janë politikanët që nuk kanë mundur të ndërtojnë kurrë shtetin e duhur shqiptar, me standarde?
Politikani duhet të artikulojë vizione ardhmërie dhe kjo domosdo e vendos në pozitë minoriteti. Në historinë e

Europës së pas Luftës së Dytë Botërore, që të gjithë politikanët që u prinë transformimeve të shteteve të tyre ishin në pozitë minoriteti dhe prinë derisa ky u bë pozicion i shumicës. Në Shqipëri shembja e komunizmit i gjeti të gjithë në pozitë të shumicës, duke dashur të largohen nga e kaluara, pa përcaktuar shumë qartësisht çfarë duhet të jetë më me përpikëri transformimi i së ardhmes. Në vrullin e turmës që kërkon të ikë nga e kaluara ende mbeten gjëra të pasqaruara e që janë themele të shtetit, si për shembull, definimi i pronës private.

Në Kosovë, politika që çoi deri në çlirim të Kosovës ishte transformative, ajo që erdhi pas çlirimit ishte e cubave primitivë zaptues. Primitivizmi tash është në përpjekje për të qenë sundim i shumicës.

Jeni një shkrimtar me përvojë, sprovuar në letërsi, i vlerësuar referuar prozës suaj, por qenien tuaj, përpjekjen për të qenë në politikë, si e gjykon tani?
Mendimi im politik, i manifestuar në gazetari e në ese, si në formën e asaj që në Perëndim quhet "intelektual publik", është pjesë e një borxhi të cilin e ka çdo njeri i shkrimit në shoqëritë që ende luftojnë për liri e shtetësi, për demokraci, fundja, siç është rasti me shqiptarët, në cilëndo anë të kufirit.

Keni fituar çmimin për të drejtat e njeriut nga organizata SEEMO në vitin 2011? A ekziston më intelektuali humanist për të cilin kanë nevojë shoqëritë tona sot?
Në mungesë të rivlerësimit të shoqërive tona nga ana e të drejtave dhe lirive të njeriut, hapësirën e pushton cinizmi me shokët e vet.

A vlen sot mendimi për të artikuluar interesat kombëtare? Si i shikoni ju raportet e sotme të intelektualëve, shkrimtarëve, me vendin, karshi politikës, mendoni se janë zbehur, pse është kjo ego aq e ashpër e politikës në të dyja vendet?
Në Shqipëri ka degradim të madh gjuhësor politik, qoftë në veprimtarinë e përfaqësuesve politikë, qoftë në media. Hapësira publike e Shqipërisë ndonjëherë më përngjan me një "reality show", një debat të pafund televiziv i cili merr rëndësi vetëm nëse ka fyerje të ndërsjellë, të folur të pesë personave njëkohësisht, ashtu që të mos kuptohet gjë, i sponzorizuar nga prodhuesit e birrës, patatinave dhe kremrave për duar.

Në Kosovë po bëhet përpjekje për ta importuar këtë model, me një gjuhë e cila është e ngurtë dhe manifeston boshllëk. Shkrimtari që futet në këtë "reality show" duhet të adoptojë rregullat e lojës. Duhet të meritojë të jetë i sponzorizueshëm prej prodhuesit të birrës, patatinave dhe kremrave për duar.

Meqë jemi në këtë paraqitje, çfarë nuk shkon në vështrimin tuaj, çfarë e bën të pakomunikueshme kulturën mes dy vendeve tona dhe pse jemi një gjuhë? Çfarë ka ndikuar, sipas jush, në këtë mungesë integrimi të përbashkët?
Në Shqipëri dhe Kosovë jemi dy shoqëri të ndryshme, tashmë edhe shtete. Ende jemi në përpjekje për t'iu përshtatur këtij realiteti të ri. Dhe ky është një proces që nuk kalohet vetëm me konsumin e kohës. Po ju jap një shembull: ne jemi rritur në Kosovë, si pjesë e Jugosllavisë, duke e quajtur veten të atillë çfarë jemi, çfarë jemi ndier, pra shqiptarë.

Herën e parë kur kam ardhur në Shqipëri jam trazuar nga një pyetje e cila këtu konsiderohet e rëndomtë, "A je shqiptar apo kosovar?", ndërkohë që për mua dhe për çdo shqiptar të Kosovës ishte thellësisht identitare dhe kështu, thellësisht ekzistenciale. Pas pothuajse tridhjetë vjetësh, kjo është një pyetje që më shkakton ndjesinë e njëjtë të pakëndshme. Ndërkohë, tash me të ballafaqohen fëmijët e mi, ndërkohë që përgjigjja për këtë pyetje ende është në formim e sipër dhe e formuluar me disa pyetje, ndër të cilat kryesorja është: "Pse nuk mund të jem shqiptar dhe kosovar?", gjegjësisht: "Si do të bëhet të jem shqiptar dhe kosovar?" Apo në fund, në kushtet kur ekzistojnë dy shtete të banuara me shumicë shqiptare e të cilat eksportin më të madh e më të suksesshëm për në Perëndim i kanë mu shqiptarët (një e treta e shteteve tona gjendet sot jashtë), "çfarë është të jesh shqiptar?".

Cili është ritmi i jetës suaj?
Është i mbushur, fatmirësisht, me shumë jetë familjare. Ka në të disiplinë leximi dhe shkrimi. Dhe përpjekje për të mos u zhytur në melankolinë e shanseve të humbura që shoqëritë tona të jetojnë më normalisht.

A jeni tani në proces krijimi?
Gjithnjë. Është tashmë një nevojë.

Si e mendoni lexuesin tuaj?
Është një mister me të cilin nuk jam marrë. Nuk besoj të kem aftësi për të kuptuar një kolektivitet, një larushi personash, moshash, interesimesh, të shkrira në një kroki-përshkrim.



Herën e parë kur kam ardhur në Shqipëri jam trazuar nga një pyetje e cila këtu konsiderohet e rëndomtë, "A je shqiptar apo kosovar?", ndërkohë që për mua dhe për çdo shqiptar të Kosovës ishte thellësisht identitare dhe kështu, thellësisht ekzistenciale.

Gazeta ExLibris hap forumin mbi përkthimin, duke ftuar shkrimtarë e përkthyes për të kontekstualizuar mbi përvoja personale çështjet themeltare të ardhjes së veprave të huaja letrare në shqip: Përkthimi: interpretim, përshtatje apo shqipërim; të përkthesh nga gjuha origjinale apo gjuhë e dytë. Këtë numër botojmë vështrimin e përkthyeses Mimoza Hysa.

PËRKTHIMI – HEQJE DORË NGA ËNDRRA E PËRSOSMËRISË

nga Mimoza Hysa

Paqja e gjumit të zhegut nën hijen e manit apo të ullirit është një ndjesi që kuptohet qartazi në të gjitha vendet e Mesdheut, në të gjitha ato vende ku kjo situatë është e jetuar dhe e njohur. Po si mund ta përcjellësh po njëlloj këtë ndjesi për një finlandez apo rus të Siberisë? A përjetojnë ata të njëjtën ndjesi të gjumit të vapës e aq më tepër nën hije mani a ulliri? Sigurisht, mund të gjendet një krahasim përafrues për prehjen dhe gjumin e drekës, por kurrsesi të zhegut që nënkupton dhe ligështimin ndaj vapës, ashtu siç mund të gjenden pemë të tjera nën të cilat mund të koten, por jo mani a ulliri. Çfarë ndodh në këto raste me përkthimin? A është kjo situatë që kërkon shpjegim kur në rrëfim është përmendur thjesht për ndjesinë e qetësisë që të fal? Përkthimi atëherë do të duhet të jetë një shpjegues, nënkuptuar si interpretim, apo një përkthim besnik, pa nevojën e shpjegimit? Po nëse synojmë të përcjellim vetëm ndjesinë, atmosferën e krijuar, a mund ta zëvendësojmë këtë situatë me një të përngjashme të kulturës së atij vendi, duke bërë një përshtatje? Në këtë rast do të përftonim një tekst të lokalizuar dhe të tjetërsuar, edhe pse mund të përcillet ndjesia e duhur. Mëdyshjet mbi mënyrën e përkthimit dhe sidomos teorizimi mbi përkthyeshmërinë vjen pas krijimit të përvojës përkthimore. Në kulturën shqiptare ky debat është i vonë, sepse është dashur të krijojmë më parë një përvojë të gjatë përkthimi për të arsyetuar pastaj mbi të. Si në të gjitha kulturat, përvojat e para të përkthimit kanë qenë përshtatje dhe rikrijime deri në tjetërsime, me një prirje të theksuar për ta *shqiptarizuar* më shumë sesa *shqipëruar* veprën. Kultura e shkrimit në gjuhën tonë është kulturë e përkthimit si përshtatje: kështu ka nisur shkrimi i gjuhës shqipe me Buzukun, Budin apo Bogdanin. Madje duke mos u ndarë qartazi ideja e shkrimit të veprës autoriale nga përshtatja.

Mjeshtëria e përshtatjes apo shqipërimit, pra e një përkthimi që qëndron më afër gjuhës pritëse se asaj burimore, që kujdeset veçanërisht për lexuesin e vet më shumë se për autorin, u arrit me përkthimet e Nolit. Ishte një hap i madh dhe i rëndësishëm për kohën kur u ndërmor dhe për nivelin e arritur, por sot ripërkthimi i veprave të Shekspirit të përkthyera nga Noli përbën një domosdoshmëri, edhe pse ngjan si përballje me një legjendë.

Janë të kaluara tashmë dhe përcaktimet antonimike për përkthimin të Benedetto Croce-s në fillimshekullin e kaluar, si femra "besnike e shëmtuar/ tradhtare e bukur". Përkthimi nuk mund të jetë as përkthim i fjalëpërfjalshëm, pra "besnike e shëmtuar" dhe as përshtatje, pra "tradhtare e bukur". Është një ndërmjetësi e zhdërvjellët që përpiqet për përsosmërinë, me vetëdijen e plotë se nuk është e mundur. Puna e përkthyesit është pakësimi i humbjeve të pashmangshme, duke sakrifikuar pjesën për të tërën. Përkthyesi kështu është gjithnjë në provë, duke nënkuptuar të gjitha shtresëzimet e kësaj fjale: është në provë në kuptimin e eksperimentit ku asnjëherë nuk dihet se si do të jetë përfundimi. Në provë, në kuptimin e mundimit, vështirësisë apo vuajtjes. Në provë, në gjetjen e rrugëve të pashkelura, të shtigjeve të reja për të shpërngulur kuptimin e stilin, tërësinë e veprës nga një gjuhë në tjetrën. Në provë, edhe në kuptimin e gabimit, keqkuptimit e moskuptimit.

Një përkthim i mirë, së pari, respekton autorin, duke ruajtur frymën apo ritmin e brendshëm të tekstit, përpos kuptueshmërisë, përmes një pune përkthimore të padukshme. Sa më pak të duken gjurmët e përkthyesit në tekst aq më i mirë është përkthimi. Më ndodh të lexoj përkthime të vlerësuara ku bie në sy puna kërkimore e përkthyesit për të pasuruar gjuhën me fjalë pak të lëvruara të gjuhës pritëse ose, për më tepër, të krijuara nga vetë përkthyesi. Kur kjo prirje nuk përbën një kërkim të autorit në gjuhën burimore, por kthehet në qëllim në vetvete të përkthyesit, e dëmton tekstin: nëse kërkojmë përcjellje sa më afër përsosmërisë, do të duhet të zgjedhim jo vetëm fjalë apo shprehje që mbulojnë anën semantike, por edhe të barasvlefshme po njëlloj në përdorim, si nga folësit apo lëvruesit e gjuhës burimore ashtu dhe asaj pritëse. Kjo për të thënë se nuk kemi stil përkthyesi, por stil autori dhe merita kryesore e një përkthyesi është pikërisht ruajtja me besnikëri e stilit të autorit.

Të përkthesh do të thotë edhe të kuptosh, edhe të respektosh tjetrin, të ndryshmin prej teje, pa e tjetërsuar dhe pa e njëjtësuar me veten. Në përkthimin e veprës së Claudio Magris-it "Udhëtim pa mbarim", për shembull, përplasja e përqasja me tjetrin, të ndryshmin prej teje, përbënte dhe filozofinë dhe thelbin e tërë veprës. Kështu që në mëdyshjen time si përkthyese, nëse duhet të ruaja fjalë apo shprehje nga një gjuhë e tretë që vetë autori i kishte sjellë pa përkthim, nëse duhet të ruaja dhe të shkruaja siç i kishte dhënë autori emërtime nga gjuhë të tjera që gëlonin në tekst, zgjodha të respektoj frymën dhe qëllimin e veprës. Për vetë Magris-in, i cili është shprehur gjerësisht dhe për teoritë e përkthimit, përkthyesi nuk duhet të bëjë rolin e ciceronit apo mësuesit që e merr për dore lexuesin, që i shpjegon gjithçka duke ia thjeshtëzuar e duke i rënë kështu ndesh ritmit të rrëfimit, por duhet ta lërë të përballet vetë me vështirësitë e të kuptuarit. Edhe lexuesi në një vepër në gjuhën amtare has vështirësi për të kuptuar tekstin, që kanë të bëjnë me nivelin e tij të nxënies apo nivelin e shkrimit. Leximi në vetvete duhet kuptuar si akt kërkimi drejt dijes dhe si i tillë ka vështirësitë e veta që tejkalohen përmes thellimit në një fjalë apo shprehje, në lexime plotësuese e kështu me radhë.

Një përkthyes i mirë i hyn në lëkurë autorit: pa e njohur thellësisht, e ka të vështirë ta sjellë besnikërisht. Mua më janë dukur të parakohshme përkthimet e disa poezive të Montale-s që kam botuar në rini. Më pas m'u desh kohë e gjatë për ta studiuar dhe për ta kuptuar derisa e ndjeva se mund të sillja të plotë një vepër të tij: e ndërmora me sigurinë që në përkthim nuk do të kishte së paku keqkuptime për kurthet që ngre poezia montaliane. Ndryshe nga filozofia që përcjell vepra e Magris-it me përballjen me tjetrin, poezia e Montale-s kërkonte një njohje të thellë të trashëgimisë së poezisë italiane, si dhe njohje të rrymave bashkëkohëse me poezinë e Montale-s.

Nëse do të diskutonim se çfarë e bën të mirë një përkthyes, do të rreshtonim së pari prirjen për të njohur dhe mësuar gjatë gjithë kohës. Brezat që po vijnë, falë edhe hapjes me botën dhe lëvizjes, janë shumë më të aftë të mësojnë rrjedhshëm gjuhë të huaja, por për fat të keq çalojnë gjithnjë e më tepër në lëvrimin e gjuhës amtare. Njohja e dy gjuhëve me të cilat punohet është vetëm një e dhënë, është hapi i parë. Përkthyesi duhet të ketë kureshtjen për të qëmtuar në kultura të tjera: ajo çka mbart si ndërmjetës nuk është thjesht gjuha, por një kulturë e tërë. Nëse nuk je një lexues i mirë, një dashnor librash, është e vështirë të bëhesh përkthyes i mirë. Në kohët e sotme përbën përparësi dhe mundësia e përballjes dhe komunikimit me autorin, gjë që ka qenë pak e mundur para viteve nëntëdhjetë. Për një përkthyes është ndonjëherë fat nëse autori është gjallë dhe ka mundësinë për të zgjidhur problemet e përkthimit në diskutim me autorin. Po kjo çështje do të përbënte një diskutim më vete.

Një tjetër diskutim që bëhet shpesh për përkthimin është dhe krahasimi i brezave të përkthyesve, me një mbivlerësim të përkthyesve të para viteve nëntëdhjetë. Për mendimin tim krahasimi është i gabuar dhe i ngjan një tifozërie pa baza shkencore. Ne kemi trashë-guar përkthime virtuoze të shumë kryeveprave të klasikëve. Po përkthimi asokohe anonte nga përshtatja shpjegimore e tekstit duke mbivlerësuar dhe lehtësuar punën e lexuesit. Kështu për arsye të ndryshimit të qasjes ndaj përkthyeshmërisë, të ndryshimeve të natyrshme të gjuhës shqipe, si dhe në disa raste të ndryshimit të qasjes ndaj veprës së autorit, shumë prej klasikëve duhen ripërkthyer. Edhe pse një sipërmarrje e vështirë për arsye shpesh edhe jashtëletrare, kam bindjen se tashmë janë formuar përkthyes të aftë për ta përballuar këtë sfidë.

Në përmbyllje mbështes parashikimin e disa studiuesve të sotëm të fushës që parashikojnë se ardhmëria e përkthimit do të jetë një shtysë drejt një uniteti kulturor shumëgjuhësor, në të cilin sinkronia do të mbizotërojë ndaj diakronisë, mendimi babelik kulturor ndaj atij linear e të njëtrajtshëm.

FILLIMET E LETËRSISË SË SHEK. XX

PRIRJET E STUDIMIT TË TEKSTEVE DHE AUTORËVE NË BOTIMET SHKOLLORE SHQIPTARE

nga Evalda PACI

Teksti si medium në një proces edukativ dhe funksional dhe në ndihmë të mësimdhënësve të gjuhës e të letërsisë shqipe ka qenë prej kohësh objekt trajtimi në botime që pikë së pari kanë pasur një destinacion të paracaktuar për shkollimin parauniversitar. Në ditët e sotme të tilla botime nuk e kanë humbur vlerën e referimit sa i përket faktit që përfaqësojnë përpilime të lavdërueshme për brezat që pasuan një proces të gjatë brendësimi të metodologjisë së mësimdhënies, por dhe të mjeteve konkrete që e ndërmjetësonin atë, ndërkohë që dhe në pikëpamje të brendisë shkencore dhe elementeve origjinale që gjurmohen në to ka mjaft për të thënë e për të shtuar.

Botimi në vitin 1936 i një vepërze që ngërthente elemente të trajtimit në një perspektivë sa gjenealogjike (E. Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*), aq dhe tipologjike të gjuhëve të caktuara e që përfaqësonin dhe referenca të mirëfillta në kuptimin e një formimi gjuhësor të nxënësve të asaj kohe, por dhe linja të vështrimit në një mënyrë të veçantë të teksteve kryesisht letrare që kishin parë dritën e botimit shekuj më parë, përbën pa asnjë dyshim një hap shënues drejt një ecurie që prirej sa nga studimi në nivele shkollore parauniversitare, aq dhe nga vëzhgime më të thelluara që shtysën mund ta merrnin pikërisht nga të tilla përpilime komplekse që merrnin parasysh rëndësinë e studimit të lamijeve të ndryshme, por themelore, të dijes e shkencës.

Rëndësia e tekstit në kuptimin e sigurimit të një feedback-u pozitiv dhe frytdhënës për nxënësit mund të receptohet fare mirë, por dhe në qasje të ndryshme prej modelesh që janë konceptuar t'i shërbejnë një edukimi kompleks në dijet e humanitetit dhe të disiplinave konkrete, siç janë gjuhët klasike dhe letërsia antike, klasiciteti me autorë përkatës e në parim me më përfaqësuesit në kuptimin e gjinive letrare që kanë përuruar, antikiteti si periudhë dhe ekzemplar i studimit të qasjes ndaj individualitetit të natyrës njerëzore etj.



Në tekstet me destinacion të mirëfilltë edukimin liceal dhe parauniversitar të përpiluara gjatë dekadave të para të shekullit të kaluar receptohet ndjeshëm një angazhim i autorit apo i autorëve për të nxitur jo vetëm nxënien e nocioneve që janë specifike për vetë botën e lashtë dhe modelet që ajo ofron, por dhe një preokupim i qartë për të shtjelluar në pikëpamje termash dhe emërtesash çka është e shqipes dhe e regjistrave kryesorë e specifikë të saj. Në një vështrim të ditëve tona shumë prej teksteve që përbëjnë paragrafë të rëndësishëm të përmbajtjes së tyre mund të jenë objekt i një vëmendjeje kritike që vë në dukje dhe diferencime të diktuara nga ndryshimet graduale që kanë përfshirë dhe arsimin parauniversitar dhe studimin e një bote të tillë, e bërë pjesë e programeve shkollore në një tjetër masë dhe në të tjera modalitete. Por nënvizimi i rëndësisë që ka studimi i një realiteti të largët në kohë dhe që nuk ka munguar të ofrojë shembuj të individit që përbën modelin e njeriut që kërkon të eksplorojë botën, që kërkon kthim në vatrën familjare mbas peripecish e ndeshtrashash që ofron jeta vetë, modele të autorit që shkruan për familjarë dhe miq duke themeluar dhe gjini shkrimore tipike të periudhës në të cilën kanë jetuar nuk duhet konsideruar i zbehur dhe i tejkaluar. Kujtojmë në këtë rasë rëndësinë që u jepet në shkollat europiane veprave themelore të letërsisë antike, asaj greke dhe latine, në kuptimin që botime mirëfilli filologjike vihen në përdorim në formate të një natyre sa didaktike dhe shkencore, duke i shërbyer një objektivi të shumëfishtë që ka prioritet formimin individual me elemente të një kulture që ka shënuar e vijon të jetë faktor për vetë europianitetin si nocion e model qytetërimi.

Modelet që mund të marrim në kuptimin e një referencialiteti gjegjës dhe që dëshmojnë dhe rëndësinë që paraqiste në vitet '30-'40 të shekullit të kaluar edukimi me disiplinat e sipërpërmendura janë të ndryshme, por gjithsesi i bashkon fakti që vëmendja ndaj aspektit didaktik dhe ofrimit të mundësisë së njohjes sa më të mirë të letërsisë klasike në shkolla ka bërë të mundur të eksplorohen metoda dhe qasje origjinale si ndaj kësaj letërsie, ashtu dhe ndaj nxënësit dhe përdoruesve të tjerë të këtyre teksteve. Përpiluesit në gjuhën shqipe janë njohës të mirë të kësaj letërsie falë dhe një formimi që përkon me vetë kohën dhe prirjet e përqendruara të saj në pikëpamje edukimi dhe formimi, por njëkohësisht do të jenë dhe për ne po aq burime referimi sa u përket disiplinave themelore studimore në albanologji: studime mbi morfologjinë dhe leksikun e shqipes, gramatologjinë dhe letërsinë e shkruar shqipe etj.

Në një kohë të afërt paraqiten me anë botimesh të tilla, si Eqrem Çabej dhe Aleksandër Xhuvani, por ndërkohë nuk lëmë jashtë vëmendjes Karl Gurakuqin dhe përkushtimin e tij për latinishten klasike dhe Atë Viktor Volajn O.F.M., i cili dha një tjetër shembull në lidhje me kompetencën e tij si përpilues dhe shqipërues i formuar me një vepërz që përbën një memorandum të qytetërimit romak në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kontribute konkrete dhe pikërisht të orientuara ndaj edukimit liceal shënohen mirëfilli nga Ernest Koliqi dhe Kolë Kamsi në fillim të viteve '40 të shekullit të kaluar, ndërkohë që promovohet përmes iniciativave të tyre dhe modeli i një antologjie që jo vetëm bën të mundur reflektimin e prurjeve nga autorë me rëndësi në historinë e letërsisë së shkruar shqipe, por dhe pasqyrimi në mënyrë të përpjesëtuar i një krijimtarie të vyer si në prozë, ashtu dhe në poezi, pa lënë mënjanë ndihmesën që jepnin në atë kohë ose pak vite më parë të përkohshme, si *Dituria, Leka, Hylli i Dritës* e që falë projektit përmbajtësor të arsyetuar prej autorëve të sipërcituar konkretizohet dhe në faqet e kësaj antologjie.

Një tipar që shërben dhe për të ndërtuar modelin e një teksti hyrës dhe shpjegues, por dhe konciz në pikëpamje vëllimi, janë pa dyshim parathëniet në të cilat autorët dhe përgatitësit e botimeve në fjalë gjejnë mundësi të shprehen e të shtjellojnë një platformë të mirëfilltë pune që duket se ka qenë për ta një palestër e mirëfilltë e stërvitjes mendore dhe njëkohësisht një mënyrë e mirë për t'u dhënë diçka serioze brezave që edukoheshin në shkollat tona. Përpos vetë përmbajtjes së veprave në fjalë, këto parathënie paraqesin interes për faktin se përbëjnë çelësa të mirëfilltë për të kuptuar më mirë shtysat e secilit për t'iu përafruar si historisë së letërsisë së shkruar si disiplinë me rëndësi edukative dhe formative për shkollat tona, ashtu dhe argumentimit të metodologjisë së adaptuar dhe që ka si objektiv kryesor tekstin letrar dhe shtjellimin sa më të qartë të tij. Në paraqitjen që Aleksandër Xhuvani i bën botimit me titull *Historija e letërsisë greke për kursin e naltë* të liceut klasik *(simbas librit të G.Sett-it),* Tiranë, 1941, pjesë e një serie botimi që ka destinacion pikërisht të ashtuquajturit *libra shteti për shkolla të mesme*, mësojmë më shumë rreth këtyre fakteve:

Këso-dore, me botimin e këtij libri ka për t'u mbushë nji e metë për nji këso vepre në gjuhën *t'onë, e më bâhet se ka për të dalë nji tekst i plotë, për t'u përdorë jo vetëm nëpër shkollat t'ona* të mesme, por edhe prej gjindsh të *lavruem, që duen me njoftë letrësinë klasike greke, të naltë e të pakapërxyeshme, që ka pasë ndëkim* të *math mbi krejt letrësit' e botës së qytetnueme.* (Xhuvani A., *Parathane*, në *Historija e letërsisë greke për kursin e naltë* të liceut klasik, Tiranë, 1941).

Duke qenë se përpiluesi i këtij botimi ka qenë dhe përshtatës dhe përzgjedhës i burimeve paralele që përbënin gjithashtu doracakë studimorë mbi historinë e letërsisë greke, plotësues me një sërë shënimesh dhe referencash që vetëm një autor merr tagrin t'i vërë në përdorim të nxënësit a lexuesit, me të drejtë i atribuojmë dhe në rasë të kësaj trajtese nga ana jonë kompetenca autoriale që e bëjnë vërtet të lavdërueshëm për botimet shqiptare një punim të tillë dhe krerët në të cilat ky

i fundit artikulohet. Do të jetë gjithashtu Aleksandër Xhuvani që do të kujdesojë dhe zërat kushtuar letërsisë klasike pikërisht në antologjinë e sipërcituar *Rreze drite*, Tiranë, 1943, pjesë e së njëjtës seri vëllimesh të emërtuar nën siglën *Libra shteti për shkolla të mesme*.

Pavarësisht trajtimit që mund t'i dedikohet në rasë të një vështrimi sa kritik aq dhe retrospektiv një botimi të tillë, nuk mund të lëmë pa vënë në dukje faktin që modeli që ofrohet në kuptimin e përpilimit të një historie të gjerë e mjaft informuese të një letërsie që vërtet ka luajtur rol në format dhe modelet gjinore të traditave të tjera letrare e shkrimore është i arrirë dhe në ditët tona mund të rimerrej sigurisht duke plotësuar me më shumë tekste dhe paragrafë ilustrues. Nga ana tjetër, si dhe për botime të tjera të së njëjtës periudhë, duhet ritheksuar që shkalla e vështirësisë së receptimit mbetet për t'u rivlerësuar, në veçanti sa u takon çështjeve që kërkojnë diskutime të zgjeruara në nivele universitare dhe pasuniversitare. Ndër të tjera, shtjellimi i argumenteve të përveçme siç është dhe autorësia e veprave që tradicionalisht i atribuohen Homerit përbën një nga pjesët më interesante të kësaj vepre, që e theksojmë nuk paraqitet në formatin e një antologjie, por të një historie letërsie të pasur me trajtime në pikëpamje të përfshirjes së autorëve dhe veprave gjegjëse të tyre.

Një sprovë të mirëfilltë që cek drejtpërdrejt dhe çështje të konceptimit të një modeli të kronologjizimit, por dhe renditjes tematike të veprave që kanë shënuar në pikëpamje periudhe dhe veçantie përmbajtësore letërsinë dhe kulturën e shkrimit shqip përbën patjetër opuskoli i sipërcituar i Eqrem Çabejt, që gëzoi dhe vëmendje kritike në kohën kur pa dritën e botimit. Duke qenë dhe interesi ynë i orientuar ndaj botimesh që kërkonin t'u jepnin vendin e merituar periudhave më të hershme të lëvrimit të shkrimit dhe kultivimit të letërsisë shqipe, vërejmë në këtë rasë që një sprovë e tillë mbetet përherë një monument shkrimor dhe për faktin që reflektoi vizionin e përpiluesit të tij për një konceptim të duhur të pranëvënies së veprave dhe autorëve, duke i dhënë kësisoj një prioritet të qartë historisë së letërsisë shqipe. Elemente trajtesash kushtuar gjeografisë gjuhësore dhe një kulture kryesisht formative mbi gjuhët dhe njohjen e tyre nuk i zvetënojnë vlerat këtij botimi, ndërkohë që rinënvizojnë dobinë e një formimi sa më të plotë dhe në këtë rasë mirëfilli pluridisiplinor. Pranëvënia e teksteve të ngjashme nga përmbajtja, por dhe me tipare të ndryshme që shpjegohen me përkatësinë dialektore dhe me rrethanat historike që ndikuan dhe në zhvillimet gjegjëse letrare përbën një prej veçorive konstitutive të këtij vëllimi, ndërkohë që rimarrja e të njëjtëve autorë, si nga tradita shqiptare, si nga ajo arbëreshe e më tej do të përforcohet dhe në botime të mëvona të ngjashme, por jo me të njëjtin autor.

Botimet në thelb të paracaktuara për përdorim në nivele shkollore parauniversitare përbëjnë në optikën tonë dhe referenca që shënojnë ecurinë e një konceptimi përherë në objekt vëmendjeje dhe të letërsisë së vjetër shqipe, një periudhë që dhe për problematikën e përfaqësimit dhe të modalitetit të sjelljes së teksteve përkatëse kërkon përherë vëmendje dhe kompetencë të veçantë njohjeje. Tekstet që sillen në këto botime të viteve '30-'40 nuk përbëjnë variante të mirëfillta transkribimi, por ndërkohë nuk paraqiten plotësisht pa vëmendje rishikimesh që sigurisht lehtësojnë në njëfarë mënyre leximin e tyre. Vlerësimi që u bëhet botimeve të tilla mund të lexohet fare qartë dhe në pikëpamje të faktit që mjaft shpejt u bënë burime referimi për studiues që ndërmorën të rindërtonin me aq sa kishin njohuri dhe të dhëna një kontekst të konfigurimit të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në një traditë më të gjerë studimesh filologjike dhe në këtë drejtim pikërisht të tilla realizime do t'u shërbejnë më së miri iniciativave të tilla.

Sa i përket përzgjedhjes së teksteve nga veprat e letërsisë së vjetër shqipe, duket qartë që Çabej (1936) e ka pasur fort të qartë ecurinë që duhej ndjekur dhe një fakt i tillë ilustrohet më së miri nëse vihet në dukje që në lidhje me të tilla vepra pjesët që i përfaqësojnë ato janë dhe bartëse të një modeli të përcaktuar e të njohur mirë si në kohën kur panë dritën e botimit këto të fundit, ashtu dhe në këndvështrimin e një tradite studimore mbi filologjinë e tekstit që i kushton rëndësi dhe hulumtime më vete si përmbajtjes dhe gjatësisë tekstore, ashtu dhe përçimit të elementeve njohëse që transmetohet pikërisht nga të tilla pjesë.

Afri metodologjike nëse krahasojmë me tekstet që afërsisht në kohë përgatit për një destinacion të tillë dhe Atë Justin Rrota O.F.M., dëshmohen nga prirja për të orientuar drejt një njohjeje komplekse që ka në vetvete dhe përforcimin e kompetencës gjuhësore dhe vetë elemente të historikut të veprave në fjalë. Letërsia e vjetër shqipe konsiderohet prej studiuesve tanë një periudhë me rëndësi në shumë pikëpamje, ndërkohë që shihet qartë që vetë veprat e autorëve të saj janë tashmë një objektiv që do qëndrojë gjatë në vëmendjen dhe perspektivat e punës studimore të secilit. Orientimi sa didaktik, aq dhe shkencor që kishte Atë Justin Rrota O.F.M. bëri të mundur që ky i fundit të përuronte disa modele në pikëpamje të sjelljes sa më të afërt të teksteve të letërsisë së vjetër shqipe dhe letërsisë arbëreshe, bashkë me ndjekjen në pikëpamje ecurie dhe modifikimi të sistemeve grafematike që pasqyrohen në vijimësi te autorët e kësaj letërsie. Përzgjedhja e pjesëve të caktuara nga veprat e tyre dëshmon dhe njohjen e mirë të përmbajtjes dhe të nëntekstit përkatës e që do ta ndihmonte Rrotën të rendiste tekste që do t'i shërbenin dhe receptimit të një brendie tipike dhe mjaft specifike si ajo e *Mesharit,* por dhe e Çetës së profetëve etj. Falë këtyre realizimeve Justin Rrota O.F.M. arriti të promovohej dhe të promovonte tekste me vlerë të veçantë, ndërkohë që përgatitja e mirë në fushë të filologjisë i mundësoi dhe përpilimin e sprovave të tjera, por më të përqendruara në disiplina

e nënsisteme gjuhësore, gjithnjë me orientim ndaj edukimit parauniversitar në shkollat shqiptare. Tekste që mbajnë autorësinë e tij e që mbeten dhe sot e kësaj dite doracakë ekzemplarë në kuptimin e koncepteve themelore, por dhe shembujve që i kanë shërbyer për të parashtruar pikëpamjet mbi elemente të sintaksës së sintagmës dhe të fjalisë janë përherë modele referimi si në dijen e didaktikës, ashtu dhe në shkencën e gramatologjisë shqiptare.

Vetë periudha që lidhet me realizimin e këtyre botimeve është mjaft e afërt me kohën kur në Shqipëri sillen kopjet fotomekanike të librit të Gjon Buzukut nga Atë Justin Rrota dhe një fakt i tillë ndikoi patjetër dhe në rishikimin e një evidentimi të natyrës në pamje të parë kronologjike në lidhje me këtë periudhë.

Të tilla sprova që i qëndrojnë më së miri një konteksti që natyrshëm e kërkonte daljen e tyre në dritë të shtypit përbëjnë dhe premisa të mirëfillta të një përafrimi ndaj filologjisë së tekstit në kuptimin që do të përshkallëzoheshin në punime të përmasave sa shkencore aq dhe të plotësuara në kuptimin e përmbajtjes dhe parametrave që përmbushnin. Në ditët tona, ndërsa diskutojmë dhe reflektojmë për çka është më e mira për brezat dhe fëmijët tanë, ndërsa vijojmë të nënvizojmë rëndësinë që paraqesin për edukimin në mosha të caktuara disiplina të dijes e të kërkimit shkencor si filologjia dhe studimi i tekstit, nuk mund të mos shtojmë se një shtysë goxha e përfillshme ka ardhur dhe nga qasja që ofrohej nga të tilla botime, që duke qenë të ndryshme për nga natyra e përpilimit dhe e sjelljes së teksteve të caktuara, janë njëkohësisht dhe unike në natyrën e vet, të denja për t'u renditur në çdo studim shkencor mbi historinë e letërsisë së shkruar dhe periodizimin sa më të saktë të saj.

Të tilla botime u kanë prirë në kohë, por dhe në pikëpamje të qasjes ndaj tekstit e studimit shkencor të tij realizimeve më të mira të cilave u referohemi si në proces të mësimdhënies në nivele universitare dhe pasuniversitare, ashtu dhe në trajtesa që kanë objekt historinë e letërsisë së shkruar shqipe dhe më saktë, periudha të veçanta të saj. Namik Resuli vite më vonë iu kushtua posaçërisht dokumenteve shkrimore që konsiderohen më të hershme dhe nuk paraqiten si vepra të plota në kuptimin përmbajtësor dhe ndërtimor, po ai do të rishikojë çështje të konsiderimit kronologjik dhe tipologjik të veprave që përfaqësojnë letërsinë e vjetër shqipe në *Parathënien* e Gramatikës së gjuhës shqipe, botuar në Bologna në gjuhën italiane në vitin 1985.

Çështja e një kronologjizimi të saktë të periudhave më të hershme të lëvrimit të shkrimit shqip është cekur jo pak në dekadat që u morën në shqyrtim, dhe një fakt i tillë pasqyrohet si në botimet që u cituan më sipër, ashtu dhe në të përkohshmet me një profil të mirëfilltë kulturor që të dala në dritë të shtypit pikërisht në atë kohë ose pak vite më parë, mbeten pasqyrë e një sinergjie jo të rastësishme dhe plotësisht të kuptueshme.

Në këto botime dhe pse të paracaktuara për përdorime para së gjithash shkollore dhe edukative do të gjejmë të dokumentuara sprovat e para për të rindërtuar historinë e alfabetit të gjuhës sonë, historinë e një kulture librore që zuri fill shekuj më parë, historinë e përdorimit të shenjave grafike pa të cilat nuk kuptohet vijimësia e traditës shkrimore që u përvijua nga një autor në tjetrin, përpjekjet e para për të interpretuar dhe vështirësinë për të sjellë sa më afër tekste që sigurisht të botuara në tipografi dhe në një kontekst kulturor të largët nuk paraqesin lehtësim për botime të mëvona e në veçanti në ato të gjysmës së parë të shekullit të kaluar.

Botime të mëvona, por të përpiluara pas vitit 1944, ruajnë qartë tipare të ndryshme në pikëpamje të trajtimit të letërsisë së vjetër shqipe dhe në veçanti ndaj konceptimit të tematikës të saj. Botime të realizuara për praktikën shkollore gjimnazike si ai i vitit 1952 (botim i Ministrisë së Arsimit) dhe që përfshin si letërsinë e vjetër shqipe dhe atë arbëreshe dëshmojnë prirje për të pasqyruar në mënyrë skematike çka përmbahej në vepra të caktuara dhe ndërkohë dhe ndaj periodizimit të historisë së letërsisë sonë të shkruar shfaqen pikëpamje që sot mund të shihen pa asnjë dyshim me një sy kritik. Nuk mungojnë shënime shpjeguese në lidhje me leksikun e secilës vepër dhe të dhëna kryesisht biografike mbi autorët, por lirshmëria ndaj trajtimit përmbajtësor të veprave tashmë shihet qartë që është rrudhur dhe priret të mënjanohet duke u përqendruar në rrethanat e pushtimeve të zgjatura që qenë pengesë për një zhvillim të qetë dhe të natyrshëm të një kulture letrare dhe shkrimore në viset arbërore. Përshtatja e plotë me alfabetin e shqipes e teksteve të këtyre veprave mbetet një tipar permanent që ndoshta e ka bërë më të lehtë leximin dhe interpretimin e tyre prej nxënësve, por ndërkohë mënjanon në njëfarë mënyre çështje të interpretimeve grafike në pjesë të caktuara. Pikërisht në lidhje me letërsinë e vjetër shqipe duhet theksuar se ka si raste përkimi, ashtu dhe mospërkimi në pikëpamje të pjesëve të zgjedhura me botimet paraardhëse, e veçanërisht në rastin e veprës së Pjetër Bogdanit vihet re se janë përzgjedhur mjaft fragmente, në atë masë sa nënvizohet kësisoj diversiteti i qartë tekstor e tematik në lidhje me këtë të fundit. Çka mund të thuhet në lidhje me të tilla karakteristika dhe elemente trajtimi që reflektojnë dhe pikëpamje të ndryshme në krahasim me botimet që u shqyrtuan më sipër, është pikërisht fakti që ndaj këtyre autorëve dhe vetë periudhës në fjalë shfaqen pozicionime më të ngurta dhe më të kushtëzuara nga ana e përpiluesve të tyre, gjë që nuk përbën tashmë një lloj vijimësie me realizimet e pak viteve më parë.

SINKRON DIHATJESH

Dom Gjergj Meta

Hana atë mbrëmje ishte e plotë. Nga dritarja hynte një fllad i lehtë plot freski nate vere. Dila i kishte hapur të dyja dritaret e dhomës që të bënin korrent. Prendi po dihaste i shtrirë në krevat. Jashtë ishte një heshtje varri. Diku larg po bëhej një dasëm. Tingujt e muzikës, edhe pse të lehtë, hynin nga dritarja. Dila hoqi rubën, lëshoi flokët, fshiu fytyrën me peshqir dhe u ul në shtrat pranë të shoqit. Vuri dy jastëkë për mbas shpine e u mbështet në ta. Po e kqyrte me kujdes kah dihaste e një pikë lot ia njomi sytë.

Prendi kishte disa ditë që ishte ashtu për shkak të hemorragjisë që kishte pësuar, por nga mbasditja nuk jepte as nuk merrte më. Vetëm sa merrte frymë.

Dila, si për herë të mbrame, u krodh ndër kujtime. Iu kujtua kur ishin martuar. Ajo atëherë as nuk e dinte kush ishte ai njeri. E kishte parë vetëm një herë në dasëm të kushrinit të tij i cili ishte prej fshatit të Dilës. Ia kishin treguar. I ati nuk e kishte pyetur fare Dilën kur e kishte dhanë. "Ashtu ishte koha, - mendoi me vete Dila, - nuk na pyeste kush". Një vajzë halle e vetja ishte bërë sebep. Kjo vajza e hallës ishte martuar te fisi i Prendit e u kishte thanë atyne se kishte një vajzë daje të mirë për Prendin. Fjala i kishte shku në vesh të atit të Prendit e ishte nis pa prit e pa përtu, sepse i ati Dilës ishte burrë fort në za e "burrit n'za, - thonte shpesh i ati i Prendit, Marka Prendi, - merrja cucën qorre". Dila dinte vetëm se e kishin fejuar, por jo se ku dhe me kë. Emancipimi i gruas, edhe pse kishte filluar të merrte hov, ende nuk kishte ardhë në shtëpinë e Dilës. Ajo e mendonte shpesh burrin e saj të ardhshëm, herë me gëzim e herë me njëfarë droje. Kishte dëgjuar shumë histori për vajza të reja që kishin marrë burra të vjetër, ose me probleme mendore apo fizike, ose thjesht pa mend në krye. Atë ditë në dasëm ia kishin tregue se kush ishte. Ajo pa se ishte një djalë i gjatë, hollak, me një trup të drejtë, flokët të krehur anash, ngjyrë gështenjë e dy sy të zinj sterrë. Si duket, edhe atij i kishte thënë dikush se kush ishte Dila. Qe vetëm një çast që e kur shikimet u shkapetën me njëri-tjetrin, pasi Dila kishte ulur sytë menjëherë nga turpi. Ajo sapo kishte mbushur 17 vjeçe. Në prillin e vitit më pas Marka Prendi kishte shkuar te baba i Dilës e kishin nda datën për në gusht të atij viti. Prendi sapo kishte mbushur 21 vjeç. Krushqit erdhën me zis, një zis i madh nga ato të minierave. Rruga ishte shumë e vështirë e erdhën deri diku afër fshatit. Dila kurrë nuk e kishte harruar çastin kur kaloi pragun e oborrit. E mbanin për krahësh daja dhe vëllai i vogël. Kishte qarë përnjimend dhe jo vetëm për sy e faqe. Ajo vetëm dinte se fshati ku do të shkonte nuse ishte shumë larg. E dinte këtë gjë nga kushërira e vet që ishte martuar në fis të Prendit. Ajo vinte rrallë në shtëpi të prindërve. Por ajo po i thonte lamtumirë shtëpisë së vet, prindërve e vëllezërve e gjithë katundit ku ishte rritur. Qau thekshëm. Deri te zisi e kishin çuar me kalë. Atje krushku i parë e mori dhe e ngjiti në kabinë. Nuk lejohej asokohe dhëndri të shkonte e të merrte nusen. Në fakt, ishte koha kur martesa ishte një ngjarje sociale. Gruaja të jepej, nuk e merrje, po ashtu edhe burri të jepej nuk e merrje. Individi ishte në shërbim të familjes e shoqërisë e jo anasjelltas.

U deshën 5 orë rrugë për të mbërritur te kulla e Marka Prendit. Sapo mbërritën ia nisi dasma. Në oborr nën tanë të rrushit ishin vendosur tavolinat e improvizuara prej dërrase. Aty ishin burrat, ndërsa në odat e kullës rrinin gratë të shpërndara nëpër dhoma përreth sofrave. Në secilën dhomë ishin mbledhur pak a shumë sipas moshës ose dëshirës, ndryshe nga vendosja e burrave që ishte sipas rregullave e familjeve.

Gratë i këndonin nuses së re duke u tallur me ndonjë nuse të vjetër. Dilës i kishte mbetur në mend dhe qeshte sa herë, një varg:

Nusja jonë si lule bore
Nusja Gjinit si zog sorre

Gjini ishte një kushëri i tyre e nusja e tij ishte shumë hokatare ndër gra. Më vonë do të baheshin shumë shoqe me Dilën. Pati shumë gëzim atë ditë. Me Dilën kishte shkuar edhe xhaja e madhe, kështu e thërrisnin nusen e axhës së madh. E kishin zakon që natën e parë nusja të flinte me një fëmijë ose më një grua të vjetër nga fisi i vet.

Natën e dytë kishte fjetur me burrë të vet. Atë natë hana kishte qenë e plotë e rrinte e shihte nga dritarja e hapur. Atë natë plot dashuri, pasi ishin dashtë, ai kishte vendosur dorën e tij të majtë nën kryet e saj e me dorën e djathtë e kishte tërhequr nga vehtja e kështu kishin pushuar nën vështrimin e hënës.

Në krye të vitit i kishte lindur djalë, Marku, e pas tij një djalë e një vajzë tjetër. Me Prendin merreshin vesh mirë. Edhe pse i ri, ai kishte shumë urti e u jepte drejtim të gjitha situatave që dilnin, qoftë edhe papritur. Jeta në kooperativë ishte e lodhshme. Zoti u fali edhe gjashtë fëmijë të tjerë, pothuaj vit më vit. Lodheshin shumë burrë e grua. Fëmijët rriteshin e shkonin në shkollë

njëri pas tjetrit. Dila edhe me barkun te buza dilte në arë me shoqe për punë. Kurse Prendi ishte zetorist.

Iu ndalën për një çast mendimet, sepse iu duk se Prendi hapi sytë e donte të thonte diçka. I kishin dalë pak djersë. Mori një pece që kishte aty dhe ia fshiu djersët te balli.

"Plak a don gja?"

Ai nuk u përgjigj fare. Vazhdoi ashtu si më parë. E Dila iu kthye mendimeve të saja. Nuk kishte qenë e lehtë për të dy jeta, por e kishin përballuar me dinjitet. Ashpërsia e urtë e Prendit në familje dhe butësia e Dilës u jepnin fëmijëve ekuilibrin e jetës, atë për çka kishin nevojë. Nuk ka një jetë të lehtë, pa vështirësi. Nganjëherë jeta të sprovon, saqë të duket se është e padrejtë. Kështu kishte menduar Dila kur Prendi diku afër të dyzetave ishte sëmurë. Një mëngjes ajo ishte zgjuar nga rënkimet e të shoqit.

"Ç'ka ke burrë?"

"Mbarova grue. Po më dhemb shumë kamba. Por ndoshta e kam prej lodhjes. Dje kam punue shumë".

"Po rri sot mos shko në punë".

"Jo, jo, do të shkoj. Sot fillojmë plugimin e tokës për misrin e dytë".

Ishte ngritur ashtu si gjysëm i çalë, kishte ndezur zetorin dhe ishte nisur për në punë. Por pas dy orësh ishte kthyer mbrapsht.

"Grue nuk jam mirë. Më ban gati rrobat e ujin se du me u la e me shku te doktori".

Doktor Astriti, mjeku i fshatit, sa e kishte parë i kishte thënë se duhej të nisej menjëherë për Tiranë. Një melanomë ishte zhvilluar në këmbën e majtë afër kyçit. Në Tiranë e shtruan menjëherë dhe pas analizave vendosën se do t'i presin këmbën deri sipër gjurit. Fati i mirë i tij ishte se tumori rezultoi mashkull, si thonin populli në këto raste.

Sa vështirë e kishte pasur Prendi ta pranonte këtë situatë, por nuk kishte ç'të bënte. Dilës i mbeti e gjithë barra e shtëpisë. Pensioni që merrte Prendi si invalid ishte shumë i vogël për nevojat e tyre. Por Dila nuk u tërhoq aspak. Rriti fëmijët. Prendi me paterica mundohej të bënte çka mundte nëpër shtëpi, duke punuar ndonjë bisht cakice, a lopate a sfurku që vinin e ia porositnin. Atij çdo ditë i rritej nderimi për të shoqen e Dilës dashuria e përkushtimi për Prendin.

Fëmijët u rritën e filluan të martohen. Martuan Markun e më pas vajzën. Po ashtu edhe djemtë e vajzat e tjera.

"Plakë, - i tha një ditë Prendi Dilës, - ndij mue. Fmijët duhet me i nda. Duhet me vazhdue jetën e tyne. Ma mirë tash e me paqe se ma vonë e me sherr".

"Ti e din këtë punë plak. Je zoti shpisë".

Në darkë i kishte thirrë djemtë e u kishte thanë vendimin që kishte marrë. Djemtë u pezmatuan e kqyrën kah gratë e tyre sikur po u kërkonin llogari. Shpesh ndarje të tilla ishin pasojë e ndonjë zënke ndërmjet vjerrave dhe nuseve, ase ndonjë fjalë e randë e thanë pavend.

"Jo, jo, mos shikoni ka nuset e juja. Ato kjoshin bekue për ne. Por ju duhet me vazhdu jetën tuej".

Djemtë kishin pranuar, edhe pse me vështirësi. Dy lugë, dy pirunj, dy gota e dy pjata, një tigan për me zi, një raft rrobash e një krevat e secili në dhomën e vet. Ndarjet në atë kohë ishin ngjarje. Nuk ishin mësuar njerëzit me u nda, pasi jetonin të gjithë nën një kulm. Vinte edhe fshati apo të afërmit për urim e sillnin diçka. Familja e re duhej ndihmuar. Prendi e Dila kurrë nuk kishin krijuar probleme me nuset e djemve. Por me urtinë e tyre e kishin kuptuar se kishte ardhur momenti.

Vetëm njëri prej djemve ende nuk ishte martuar. Madje as e kishte ndër mend. I vetmi që kishte shkuar në shkollë. Ishte djali i pleqnisë. Ishte edhe më i përkëdheluri.

Dila hodhi sytë edhe një herë nga Prendi. Frymëmarrja po i vështirësohej. Nxori pak sekrecione nga goja e Dila ia pastroi me kujdes. Ia përkëdheli pak kryet e iu dhimt shumë. Përsëri një pikë lot ia lagu faqen. Ndoshta edhe ai e ndjeu dorën mbi ballë, pasi edhe atij i doli një pikë lot nga sytë. Dukej sikur lotët po shihnin njëri-tjetrin e dilnin njëherësh.

Ai, pra djali i vogël, ndodhej në Tiranë kur u hapën ambasadat. Ishte në vitin e fundit te Fakulteti i Ekonomisë. Iku me shokët e u fut të ambasada

gjermane. Kur i shkoi lajmi Prendit dhe Dilës, ata sa nuk mbaruan prej dhimbjes. Dila qante ditë e natë, ndërsa Prendi u mbyll në shtëpi e nuk dilte më. Vetëm pinte duhan e nuk fuste gjë në gojë. Ishte i vetmi djali i tij nga gjithë katundi që kishte ikur. Në katund u hap zëri. Filluan mbledhjet e ta quanin tradhtar. Në shtëpinë e Prend Markut dukej sikur kishte rënë zi. "Ma mirë të më kishte dekë ai djalë!" - thonte Prendi herë me zë e herë nën zë. Asohere iu kujtua Dilës se kishte ardhur në shtëpi një burrë i katundit që kishte qenë në burg për shumë vite. Ishte kumbarë i shtëpisë. Kishte hyrë Brenda, ishte ulur dhe i kishte thënë Prendit: "Or Prend Marku qenke ngushtu fort. Por nuk ka me kalu shumë kohë që ke me pa se djali jot ka ba gjanë ma të mirë. Kjo punë ka marrë fund. E ata që sot shajnë djalin tand e ty, nesër ke me i pasë të gjithë rrugëve për me ikë dikah. Kemi me qenë gjallë unë e ti. Po hajt tash na e nxirr ka nji pikë raki e hiqe at idhnim prej fytyret se nuk ta shoh dot."

Në Gjermani djali bëri dokumentat, filloi punë e sapo ra sistemi krejt erdhi me taku prindërit e vllezërit. E kishin pritur si mbret e të gjithë ata që e kishin sharë tani i ishin bërë rreth duke e pyetur se si është jeta andej. Ai nuk u kishte dhënë shumë përgjigje, por u kishte thënë vëllezërve të vet: Bëhuni gati. Do t'ju bëj dokumentat e do të vini me mua. Do të ikim nga ky vend.

Prendi nuk i kishte ndalur e as Dila, por ata vetë nuk deshën të shkonin. "Nuk vij jo. Shkoni ju. Unë do të rri këtu. Nuk e la kullën e tokën e të parëve". Brenda një viti i mori të gjithë, vëllezër e motra me gjithë nuse e dhandrra. Prendit e Dilës kur u ikën nipat e mbesat sikur t'u kishin shkulur zemrën prej vendit. Megjithatë kishin duruar e i kishin përcjellë me buzëqeshje fëmijët. Koha kalonte e ata vazhdonin jetën e tyre në fshat. Fëmijët jetonin të gjithë në Gjermani. Filluan të vinin çdo vit në verë. Me kalimin e viteve vetëm një herë në dy vjet e filluan ta rrallojnë krejt. Nganjëherë vinin vetëm djemtë, por nuk sillnin më nuset e as fëmijët.

"Kushton shumë të vijmë të gjithë", - thonin. Dy pleqtë nuk thonin gjë. Kënaqeshin sa herë vinte ndonjëri e kur guxonin t'u thonin se i kishte marrë malli për fëmijët menjëherë shtonin: "...por mos kini merak se e dimë se ju kushton shumë." E vërteta ishte se ata po thaheshin për fëmijët e tyre e për nipat e mbesat. Kështu ditët kalonin, fuqitë i linin gjithnjë e më shumë. Dila nuk ishte më e zonja si përpara. Prendi mezi ecte me patericën e tij. Nganjëherë vinte ndonjë kushëri i tyre nga ata që kishin mbetur aty e i sillte ndonjë gjë.

Deri ditën që Dila u kthye nga kopshti dhe e gjeti Prendin të shtrirë përdhe, te pragu i shtëpisë. U mundua ta ngrinte, por nuk mundi. I çoi fjalë një kushrinit të Prendit aty afër që erdhi vrap dhe e ndihmoi. Kur erdhi mjeku i tha që kishte hemorragji cerebrale. Nuk do të zgjasë shumë. Ndoshta 24 orë ose një javë maksimumi. Prendi sa me zi fliste. Fjalët nuk i dalloheshin. Sapo iku mjeku Dila doli në oborr, mori telefonin e thirri Markun, djalin e madh: "Baba asht smund Mark. Shumë smundë! Hajdeni se nuk i dihet a e gjeni gjallë." Ata kishin lajmëruar njëri-tjetrin. Avioni më i shpejtë ishte të nesërmen në mëngjes nga Munihu. Prenë biletat të gjithë. Edhe fëmijëve. Kushrini i Prendit që banonte aty afër ndejti deri vonë. Pak para mesnate u ngrit me dalë. Kur doli te dera, i tha Dilës: "Në paç nevojë, m'i bjer telefonit se po e mbaj ndezun te kryet e shtratit e nesër në mëngjes do të vij herët." "Po, po, mos ki merak. Por ma mirë dilu djemve nesër përpara në aeroport se ndoshta kanë nevojë për dikënd. Unë sa me i dhanë ilaçet plakut mundem vetë". U ndanë. Dila u ngjit në kat të dytë të kullës aty ku kishin vendosur Prendin, te dhoma e tyne, në atë krevat ku kishin kaluar 60 vjet bashkë. I ktheu sytë edhe njëherë nga Prendi. U shtri. I vuri dorën e majtë nën krye të tij e tjetrën përmbi gjoks. E tërhoqi pak për kah vejta, ashtu sikur bënte ai pasi e kishte dashtë. E puthi në ballë. Hëna jashtë pothuaj nuk kishte lëvizur fare nga dritarja e tyre e tingujt e asaj dasme atje larg kishin reshtur. Dy gropa të zeza të hënës dukeshin si dy sy që kqyrnin me kujdes e dhimbje. Dila afroi kryet e saj të kryet e Prendit. Frymëmarrja e saj kapi ritmin e dihatjes së Prendit. E kështu u nisën të dy.

Të nesërmen punëtorët hapën dy varre në atë kodër të fshatit nën ato lisa që kishin mbetë afër Kishës.

SI PIKË UJI E AVULLUAR

Delvina Kërluku

HUKAT NATA

Lërmëni të prehem midis lulesh që lulëzojnë
Të rilind nga lotët e mi që lagin brigjet e shpirtit tim
Ta njomin zhurin e dashurisë që mbase tretet
Dhe plaga thith dhimbjen e pafund
Flakëroj në flakën e qiririt flakëpak
Kërkoj burimin e haresë sime të llastuar
Të ditëve që do t'i shndërroja në shekuj gëzimi
Drita, nën peshën e kësaj zymtie është fshehur
në kujtime.
Nën qiellin pa yje, hukat nata ime e shurdhët …

NATA E MAJIT

Sonte lundroj me anijen pa vela e pa direk;
Më rrëmbeu lumi i mërzisë.
Jeta u bë si det vaji dhe flladi s'kishte pikë freskie.
Zemra ulërin posi sirena që mbushnin rrugën
tonë plot zhurmë.
E kam mbyllur në vete sekretin që më lidh
me ditën tonë të fundit bashkë.
Do të doja ta takoja në dramën e Shekspirit e të
vdisja kur bie perdja,
Për të mbetur përherë në skenë.
Ofeli në dashuri.

UJËRAT PUQEN

I ëmbël është lumi im andej nga vij,
I njelmët është deti këtu ku jam
Dhe largësia, na ndan, na ndan
Shpirtrat qiellit pa kufij fluturojnë
Si pulëbardhat, mbi detin tim,
Liqenin tënd, lumin tonë.
Dhe shpirtin ma qetësojnë
Mallin për ty seç ma trazojnë
Uji rrjedh trupit tim, me rrëmbim
Zbut gjithçka të acaruar, shqim.
Vijnë lumenjtë andej-këtej
E puqen si të përmalluar
E çmallen si të dashuruar
Unë shkrihem në detin e bukurisë
Mbase heq mallin e Dashurisë.

Zhyta gishtat e bardhë në Detin e Zi,
Mblodha guacat që pëlqen ti
-Kyçi aty kujtim e mallëngjim,
Veç jo largim, veç jo trishtim!

Sozopol

PORTRET

Në largësi fytyra përhumbet, si pikë uji e avulluar
Mundohem të rizgjohem, t'i çel sytë të të gjej
Ti je larg, nuk e di sa larg je ti, por e di se
Largësia peshon sa vetë largësia, sa malli për ty!
Ndjenja shfaqet dhe rreh krahët lehtë e lehtë
E gjallë dashuria si rrahja e zemrës që ritmin ritmon
Malli im banon në dritën e hënës së plotë
Në dorën e piktorit dhe fjalët e mia varg
Largësia më bëri të krijoj fytyrën tënde
Ku shiu të kishte lagur, për aq sa kishte rënë
Ku dielli të kishte përflakur, për aq sa kishte përvëluar
Ku vetmia të kishte rrëmbyer, për aq sa ndihesh
i vetmuar
Ku guximi të kishte shoqëruar, për aq sa bëhesh
i pathyer
Ku bukuria të kishte zbukuruar, për aq sa
hijeshia tepronte
Ta bëra portretin nga malli, për ta vrarë
vetminë, harresën!
Tani më s'do ndiej ftohtë në çdo frymëmarrje.

Delvina Kërluku (Dibër, 1985) kreu Fakultetin e Ekonomisë, dega Administrim Biznesi, drejtimi Marketing, pranë UEJL, Tetovë. Studimet pas diplomimit i kreu në UKM, Shkup. Botoi libra me poezi, *Muza*, *Altar*, *Gjurmë*, *Varg vese*, *Fjordet e vetmisë*, *Deja e vjeshtës*, prozë *Pasthënie e ditëve tona* dhe publicistikë *Im Atë dhe këlyshët e Titos*. Është nderuar me çmime letrare: "Vepra Letrare" – Prizren; "Çmimi Special" – Korçë; "Ura Letrare" – Shkup; "Dallga Poetike" – Strugë. Çmimi "Abdylazis Islami" – Shkup.

Merret edhe me publicistikë dhe shkruan gjithashtu artikuj shkencorë. Ka marrë pjesë në takime të formatit akademik si dhe në manifestime kulturore-poetike në vend dhe jashtë vendi. Delvina Kërluku ka qenë kryetarja e parë e shoqatës "Josif Bageri". Është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë në Maqedoni dhe anëtare e kryesisë së Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë. Redaktore e revistës për letërsi, art dhe kulturë "Stozher" (*Shtylla*), organ i shoqatës. Jeton e vepron në Shkup.

PATËR SHTJEFNI

Nga Hyjni Ceka

Skicë nga Bujar Kapllani

Elbasani ynë, mes sa e sa ndereve, gëzoi dhe një emër të madh se, në verë të vitit 1924, mbajti Shtjefën Gjeçovin në gji të vet.

Atë mot, Patër Shtjefni, merrej me hartën arkeologjike të Shqipërisë... Me të hyrë të gushtit, cërr vape, zuri vend në Elbasan, në strehëzën e priftërinjve "unitë".

Ndërmori inkursione, nëpër Krrabë e Grykë të Zaranikës, në Shpat e në Polis... Përfund, kish lënë Dumrenë me Sulovë, bashkë.

Ekspeditat e priftit, qenë si bredhjet e lypësve. Në pikë të zhegut, rendte, mbledhur me "zhgun" e me konop për brezi... Sandalet "ala skiave", i hiqte rrëshqanë. Mjetet e punës, futur ndër strajca... Hedhur krahëve dhe ato...

Me shkop! Bridh, gjithë ditën... e ditës...

Me t'u dhimbs!

... Veç, kur bëri ballë, një mëngjes, në Qafë të Belëshit. Katundarët qenë mbledhur buzë gjolit, përkëndej...

Tek e panë me të murrme, nga majë e kokës-përfund këmbëve, morën frikë. S'u pat rastisur të shihnin fretër herave, të tjera...

... Profesor Simoni shkonte verën, atë mot, gjoleve... Vjen e u thotë belshakëve:

-Ç'bindërohi ashtu, ore çuna? Ai që varet Qafës për teposhtë, është shenjtor e Bari i Zotit Krisht... I diçmi i dheut! Vjen këndej për punë diturie.

Katundarët vunë profesorin në mes... Morën rrugën për tek Ura, në hyrje të Belëshit...

Prifti u rrok qafa-qafë me Simon Shuteriqin.



Belshakët u vunë në radhë, si të takoheshin me Perëndinë vetë... Merrnin dorën e Patër Shtjefnit dhe e puthnin gjithë përvujtni.

Bregu i liqenit, ato kohëra qe plot hije. Dushqet - si plepa-digdrejtë. Në prehër të gjithë atij blerimi,

u shtrua Atë Shtjefni, me belshakë dhe elbasanas. Plloskat e verës, përpara... dhe mish helli. Atë pritje s'e drejtonte veç Simon Efendiu. Për konakbash, dukej se qe Mihal Tyxhari. Prej qyteti, por me veshje katundi.

Shtjefën Gjeçovi, si për kreshmë. Piu verë. Mishin... as e preku... Te rrinte... si ndër gjemba...

Një herë-dy herë, i ra në sy gjindjes.

-Uratë! -foli Mihal Tyxhari, -zgjatu një çikë e na ndero sofrën... Këtë harxh për ty e kemi shtruar... për vete, mishin, zor se na e shohin sytë, në mot një herë... Po, ja, me sebep! Ha miku, hamë dhe ne!

E rënduan Padren, me ato fjalë... Nderi dhe ai duart e mori një fije brinje qengji.

Te përçapej i menduar, çoi kryet përnjëherësh dhe i doli balli në pah e sytë i xixëlluan me dritë shenjtërie.

-Jam kah ngutem, ore vllazën!... E mos më gjykoni për të keq! Vërtetë rri këtu, mes njerëzve të mi, po mendtë i kam në atë sukë, kundruell. "Gradishtë", a ça tjetër asht?!

Belsh po ju thonë... e Bardhaj ju kanë pas thanë... Dhe ajo "Gradishtë", s'asht tjetër, por "Gjytezë" e Bardhajve të moçëm. E Bardhinëve ilirë...

Si jehoi ajo fjalë anë gjolit! Zot, ç'jehonë që pati! Dhe u hapi sytë njerëzve! U çeli veshët! U kthjelloi mendjet!... Ku paskemi pasë qenë?!

Mihal Kallupi, ai tyxhar i urtë, qe i pari, mes gjithë atyre, që e kapi merakun e të diturit... U çua lingthi dhe iu drejtua Atë Shtjefnit me këto fjalë:

-Ti na drejto, o njeri i mirë! Jemi gjindje e kemi mall të gëzojmë me barinj e shenjtorë... se lum që na i solli Perëndia!.. Ku rreh mendja jote. Ju e dini... ne kemi dëshirë t'Ju ndihmojmë me ç'të mundemi... Se e dimë që Zoti Ju ka drejtuar për te ne... E ju punoni e robtoheni të çoni në vend urdhrin e Atij që Vranë e Kthjell!...

Prifti ndjeu veten të lehtësuar...

Së fundi, Perëndia, me të madh të vet, ua kish bërë të qartë këtyre njerëzve misionin që kish marrë mbi shpatulla... U çua aty, si me lejë të katundarisë dhe bëri të marrë përpara...

-Dale!- tha atëhere Mihal Tyxhari,-deri këtu erdhe filli, se nuk ta kish blerë njeri mendjen. Gjer sipër, do të nisemi top e trumbë... Ne e morëm vesh se kush ta ka ngarkuar gjithë atë barrë... Punët e Perëndisë do t'i kryejmë dorë për dorë... Të gjithë bashkë...

U ngritën belshakët.

Mihali u vu në krye.

-Sofrën merreni me vete, o çuna! Ajo na duhet!

U nisën... Parpara, të tre: Simon Efendiu, prifti dhe tyxhari... Simoni., me bastun e xhaketë, mbas krahëve, intelektual në kohë të vet.

Ec e ec e veç, ku iu doli ajo Sukë e Gradishtës përpara... U ngjitën tërthoraz... dhe arritën së fundi në atë ballkon, që veç Dumreja e ka. Shqipëria, jo njëherë... Po, edhe nëpër botë zor se e gjen...

Sheshi, në breg, gur e mur i tëri... Dushku vendin ia kish lëshuar gorricës e... blerimi, rigonit.

Zhegun e freskoi thëllimi. Simoni, atje lart, veshi xhaketën dhe u kopsit.

Të diturit, zënë përkrahu, dolën buzë shkëmbit... Ia hodhën sytë gjithë asaj rrumbullakeje, që zinte prej Krrabe e përfshinte Çermenikën, gjer në Qafë-Thanë.... Syri kapte veç male: Polis e Bukanik e Majat e Sulovës, një për një.

Në këmbë të maleve, shtrohej qilimi i fushës... Shkumbin e Devoll, çanin nëpër blerim, duke vezulluar e duke kaltëruar...

Çunat e ngjitën "sofrën" gjer lart.

Mihal Tyxhari e ndreqi nën hijen e shqyer të një gorrice plakë... Hoqën "mehramanet" nga brezi katundarët dhe shtruan si për tryezë shkrimi.

Patër Shtjefni hapi letra e harta aty... Pastaj, mori e dha... me busull e me teodolit. Simoni nuk iu nda... E ndiqte hap mbas hapi. Bënin përllogaritje në fletore xhepi... e merr e hidh, pastaj, nëpër fletë e nëpër harta...

Belshakët, gjithë sa ishin, bënin sytë katërsh e... mirë se nuk i shqyenin! I merrnin ato punë, si marifete magjistarësh. Nuk kishin faj, të zestë!

Ku njihej te ne, në ato vite të mugëta... rilevimi dhe hartografia! E... sidomos, në Dumrenë e dushkajave... e në Belshin e gjoleve!

BISEDË ME DJALLIN

Nga Rexhep Ferri

1.

Një parashikues më tha:
- Më falni që ju gënjeva.
Duke ia dhënë edhe një mundësi vetes, po shkoj të bëj edhe një bisedë me djallin.
Ende nuk e di ç'mendim ka Zoti për ne.
Duhet t'ia lëmë kohës.
Unë nuk e prisja këtë ditë.
Për sekretet e bisedës do të flasim kur të kthehemi.
Tani kam frikë nga ajo që nuk e di.
Psehu lyp durimin dhe kohën e vet.
Sot nuk u besoj as njerëzve, as fjalëve.
Pa u ndalë po marr frymë:
- Jo vetëm si kërkesë.
- Jo vetëm si takim.
As fundi nuk e di a ka fund.
Të humbur nga gabimet shpejt e shohim se kënd e kemi dashur dhe kush na ka dashur.
Me asnjë fjalë më shumë, vonë e kuptuam se çka duhet të harrojmë.
Kur historia përsëritet për ta humbur edhe një luftë!

2.

S'dua dashuri!
Dashuritë i kemi të mbushura me gënjeshtra.
S'dua as gjakime, gjakimet i kemi për t'u takuar me djallin.
As tokë nuk dua, gjysh pas gjyshi tokën e kemi me histori që përsëritet.
Nëse më pyesni se kush jam, ju them se jam një gozhdë e ngulur në murin e Muzeut të Njeriut.
Pa turp, pa kripë, e pa kokë, ky shekull nuk do të jetë i lehtë.
Për ta humbur edhe një luftë ku shkuan shekujt e shqiptarëve?
Më falni, kush jeni, më kapi frika ç'do të ndodhë?! Ku do të arrijmë.
Jemi ngulur si hu gardhi.
Shesim mend, shesim mend.
Kush beson, beson.
Për njeriun që e ka shitur shpirtin, çmenduria është gjë fisnike.

3.

Për shpëtimin e kohës së ardhshme, çfarë fati është duke na pritur?
Mendja e djallit ka zbritur mes njerëzve.
Komunikimin do ta kemi me nota të larta muzikore.
Humbi kush humbi, fitoi kush fitoi.
Ditën e mirë, njerëz të mirë.
Ndoshta jeni të prirë për të bërë gabime që nuk i kuptojmë.
Shkel e shko veten e pyeta: Si shkohet në luftë dhe si kthehemi nga lufta?
Për ta djegur Romën, me djallin e mbylla.
Po kënd ta kërkoj.
Fama e shejtanit ka zbritur në tokë.
Punë leshi.
E turpshme, për të thënë ka kohë që s'e kuptojmë. Ka kohë që s'ka shpjegime.
Për të thënë, më fal, nuk do të kemi kohë.
Me një po, me një jo, e plakim ditën dhe gjysmën e jetës.

4.

Aty ku nuk ka armiq, ka frikë.
Kush do të na mbrojë.
Jemi afër.
Duhet të harrojmë se jemi larg.
Nuk po e kuptoj pse?
As koha s'ka asgjë për të thënë.
Marifetet e djallit po na pëlqejnë.
Kush do të na mbrojë nga paturpësia.
Erdhi koha të mos kemi kohë.
Edhe kur nuk kemi asgjë për të thënë, avullohet uji, zbutet gjaku, zhduket sekreti.
Dita vishet me mjegull.
E nata – kërratë, kërratë…
Një profesor universiteti i cili para lufte ka qenë çoban më pyeti:
Kah të shkojmë?
Unë me ironitë e fatit, për një ëndërr përtej ëndrrës sot për sot, nesër për nesër: gjeje ditën i thashë:
Me gënjeshtra e falënderime, çfarë të bëj nuk po e kuptoj.
Jemi afër ta humbim edhe një rast.
Na ka zënë terri.
Duhet të harrojmë se jemi larg.
Viti i kthimit është metaforë.
Nuk inspirohem nga humanizmi, por nga autoportreti i nisur e i pakryer.
Për këtë hall që po na kthen në Mesjetë, as koha nuk ka asgjë për të thënë.
Kur e shohim Djallin, e harrojmë Zotin.
E harrojmë Njeriun.
E harrojmë edhe Vdekjen.
E harrojmë edhe Frikën.

5.

Histori për histori.
Kur nuk kemi asgjë për të thënë, historia mezi pret të përsëritet.
Nuk po e kuptoj pse?
Kjo botë ndoshta është lodhur nga vetvetja.
Pa asnjë lloj besimi.
Me të njëjtat gabime.
Zoti nëse na sheh, na kupton.
Për të arritur deri te maja e botës, ku zemra bëhet mal jeta na vjen si kërcënim i bukur.
Kur ndalemi e pyetim se çka të bëjmë me suksesin.
Pa kuptuar asgjë na pëlqen të besojmë.
Të gjitha marifetet kontaktet i humbëm si gurin në lumë.



Të kaluarës ia lemë të kaluarën.
Të ardhmen nuk e dua.
Na është e panjohur.
Në parajsën e bardhë Njeriu i mire vdes me dy gishta fytyrë në ballë.

6.

Kam dëgjuar dhe kam njohur shqiptarë që kanë jetuar dhe kanë vdekur për ta bërë shtetin shqiptar.
Edhe kur historia hesht, në këngën popullore fjala i takon jetës.
Jeta ëndrrës.
Ëndrra magjisë.
Magjia legjendës.
E legjenda zemrave që i ndezin zemrat për jetën.
Për jetën e popullit.
Në fushën e mendjes.
Në fushën e mejdanit ku nuk shihet asgjë si vlerë.
Kujdes.
Drita e zezë është më shumë se ngjyra e zezë.
Kur drita e bardhë s'bën punë.
Ma jepni ta shikoj.
Ngjyra e zezë përfaqëson kohën që na shikon se ku po shkojmë.
Ka të drejtë të jeton me rrezikun.
Duhet ta kuptojmë.
Lufta bëhet për të fituar.
Kur e bëjmë të njëjtin gabim deri ku shkon e keqja.
Dikush mund të mos e kupton.
Ku shkoj fati i njeriut.
A e pa kush se ku shkoi?
Kush i fiki dritat?
Më mire të fiken se sa të shohin dritën e zezë.
E të mbetemi vet.

7.

Nuk po e kuptoj pse e bëjmë të njëjtin gabim.
As koha nuk ka asgjë për të thënë.
Për të shpëtuar nga mëkati është fat i rrallë.
Për t'ia thyer vetes qafën, patriotët mashtrues na e prekin zemrën.
Për largpamësinë e tyre s'kemi asgjë tjetër për të thënë.
Po ndodhi edhe një ndryshim, ata prapë do të shkojnë deri në fund të historisë.
Brenda e jashtë kufijve njerëzorë të popullit që pret, të popullit që kërkon.
Për fatin e njeriut lind mungesa e besimit.
Me maskat e interesit kuptohet urrejtja.
Ky ndryshim, edhe pse ende nuk është ngritur në këmbët e veta, ku e ka shpirtin?
Famën e rrallë askush nuk e çmon.
Për një palë sy, për një palë fjalë, bari do të rritet mbi ne dhe do të na tregojë nata a është me hënë apo pa hënë.
Me durimin e dashurisë, ku ta gjejmë zjarrin që e ruan sekretin;
Që shkon në një takim për të dhënë diçka dhe për të thënë diçka si pjesë e tretë e iluzionit.

Korrik 2019

Festivali Zâ Fest rikthehet në Theth nga data 2 deri më 4 gusht. Organizatorët rrëfejnë risitë që do të ketë në këtë edicion të tretë, ndërsa kantautori Vlashent Sata shpjegon se nuk do të mungojnë muzika dhe gojëdhënat

MUZIKË, GOJËDHËNA DHE SHËTITJE NË ZÂ FEST III, NË THETH

nga Valeria Dedaj



Edicioni i tretë i Zâ Fest rikthehet në Theth. Rizgjimi i shpirtit të këtij vendi, rikthimi i vëmendjes drejt kësaj perle të Veriut të Shqipërisë dhe shndërrimi i saj në pikën e takimit të kulturave të ndryshme përmes artit si gjuhë e përbashkët, ka qenë dhe është qëllimi i realizimit të këtij festivali.

Kantautori Vlashent Sata shpjegon se ky festival synon bashkimin e njerëzve, duke ftuar artistë vendas, fqinjë dhe nga vende të ndryshme të botës, duke mundësuar kështu një bashkim të gjerë kulturor. "Dëshira për realizimin e këtij festivali ka lindur nga unë, por e frymëzuar nga artistë të tjerë që kanë dashur përherë të jenë të angazhuar për të bërë diçka për Shqipërinë. Zâ Fest ka lindur vetëm me idenë për të pastruar Thethin, ku arti të ishte një formë përbashkuese për të pastruar natyrën. Ky ka qenë çelësi i parë, që ne të bëjmë diçka për vendin, që të pastrohet nga mbeturinat, por në të njëjtën kohë ka qenë që të sillnim diçka kulturore që e shikojmë në të gjitha vendet e botës, duke bashkuar artistë nga të gjitha trevat shqiptare. Por edhe njerëzit që janë në Theth t'i trajtojmë jo si njerëz të izoluar, por njerëz që kanë shumë vlera, sikundër është edhe mikpritja", - shprehet drejtori artistik i festivalit, Vlashent Sata.

Më tej, kantautori shton se risia kryesore e këtij festivali është takimi, Logu i Zâ Fest, ku njerëzit mes bisedave të shkëmbejnë eksperienca dhe ide, duke qenë aktivë për të ndryshuar diçka në jetën e përditshme, ku mbase ata që janë shumë të lodhur, nuk kanë më forcë fizike që të reagojnë. Zâ Fest kërkon që njerëzit të bashkohen për të ndryshuar diçka. "Ky festival, me dëshirën e shumë artistëve që janë të pranishëm edhe këtë vit, ka bërë të mundur shumë gjëra, prandaj ka atë lloj gëzimi dhe entuziazmi nga publiku, sepse në thjeshtësinë e vet kërkon që të kthehemi te vlerat tona, për të ndërtuar dhe për të riparuar ato pjesë që do të na bëjnë të ecim përpara", - shton Sata.

Më pas Sata vijon të shtojë se për të zhanret e ndryshme të artit janë një. "Unë kam punuar me shumë disiplina të ndryshme që i quaj të nevojshme, që të gjitha këto të jenë pjesë e festivalit, pasi janë përqafuar edhe nga publiku", - thotë kantautori.

Këtë vit artistët pjesëmarrës janë: Elina Duni, Piers Façini, Vlashent Sata, Arben Bajraktaraj, Bob Berkey, Agona Shporta dhe "Don't listen to your Neighbors". Por nuk do të mungojnë as aktivitete të tjera si hiking, joga, panair kulinarie, kinema verore, tregime & legjenda dhe biseda e hapur "Logu i Zâ Fest".

"Zâ Fest është një festival që bashkon artistët nga mbarë bota për të bërë bashkë artin në një dimension tjetër. Në këtë edicion kemi të ftuar artistë shumë të njohur, si Elina Duni, Arben Bajraktaraj apo edhe Vlashent Sata, Bob Berkey Clown, që do të jenë me performancat e tyre në festival. Zâ Fest është krijuar për të shkrirë kufijtë. I gjendur në një terror mes Alpeve, një vend që është i lënë pas dore nga infrastruktura dhe zhvillimi social, dëshira e Satës është që ky festival të shkojë pikërisht atje. Pasi ne kërkojmë që t'i bëjmë vendasit që të kuptojnë se me artin ka zhvillim. Veriu i Shqipërisë ka nevojë për më shumë aktivitete, sepse Zâ Fest është i vetmi që zhvillohet atje", - shprehet Albana Rica, organizatore e festivalit.

Kush jemi ne? Çfarë bëjmë dhe ku do të shkojmë? Në datën 4 gusht do të bëhet një bisedë e hapur në Logun e Kishës, ku do të diskutohet për rininë.
"Ku është rinia shqiptare sot? Si është raporti i saj me tokën? Për këtë do të jenë prezentë antropologë edhe filozofë, së bashku me publikun e thjeshtë", - shton Rica.

Zâ Fest

Zâ Fest është krijuar nga Vlashent Sata në gusht të vitit 2017 me idenë e krijimit të një strukture që rizgjon vlerat shqiptare, kultivon artin i cili bashkon njerëzit në gjuhët e tij universale, ndihmon popullatën vendase në pikëpamje sociale, zhvillon ekonominë lokale, rajonale dhe kombëtare, ruan natyrën dhe përgjegjësinë në raport me të. Dëshira është që të gjithë të rritemi me Zâ Fest, të udhëhiqemi nga kultura dhe e bukura për të rizgjuar shpresën në këtë vend që kaq shumë e ka të nevojshme dhe i mungon. Festivali do të zhvillohet në datat 2, 3 dhe 4 gusht në Theth.

"Kantautori Vlashent Sata shpjegon se ky festival synon bashkimin e njerëzve, duke ftuar artistë vendas, fqinjë dhe nga vende të ndryshme të botës, duke mundësuar kështu një bashkim të gjerë kulturor.

KADARE NË LISTËN E FINALISTËVE PËR ÇMIMIN NDËRKOMBËTAR LETRAR NEUSTADT PËR VITIN 2020

Nëntë shkrimtarë të shquar nga e gjithë bota janë zgjedhur si finalistë të Çmimit Ndërkombëtar Letrar Neustadt për vitin 2020. Çmimi, i cili ka një vlerë prej $50.000, është cilësuar si "American Nobel" dhe akordohet nga *World Literature Today*, e cila është revista e Universitetit të Oklahamas për letërsinë dhe kulturën ndërkombëtare.

Të nominuarit janë: romancieri dhe eseisti shqiptar Ismail Kadare (*Broken April*, *The General of the Dead Army*); romancieri francez Emmanuel Carrère (*The Adversary*, *Class Trip*); poeti amerikan Jorie Graham (*Fast*, *The Dream of the Unified Field*); romancierja dhe dramaturgia filipinase Jessica Hagedorn (*Dogeaters*, *Mango Tango*); romancieri guatemalas Eduardo Halfón (*Mourning*, *La pirueta*); romancieri palestinez Sahar Khalifeh (*Wild Thorns*, *Of Noble Origins*); poeti maroken Abdellatif Laâbi (*Beyond the Barbed Wire*, *The World's Embrace: Selected Poems*); poeti dhe romancieri kanadez Lee Maracle (*Celia's Song*, *Ravensong*); poeti vietnamezo-amerikan Hoa Nguyen (*Red Juice*, *As Long as Trees Last*).

Juria prej nëntë vetash, të gjithë shkrimtarë, do të takohet për të zgjedhur fituesin në festivalin "2019 Neustadt Lit Fest", i programuar për 15-17 nëntor, organizuar nga revista *World Literature Today* dhe Universiteti i Oklahamas. Fituesi do të shpallet më 16 tetor.

"Është emocionuese të kemi një grup kaq të vlerësuar shkrimtarësh që konkurrojnë për Çmimin Neustadt", - thotë Robert Con Davis-Undiano, drejtori ekzekutiv i revistës letrare *World Literature Today*, i cili është edhe sponsori i këtij çmimi. - "Letërsia është një zë i fuqishëm që na mëson për botën përtej vetes sonë. Ky grup vërtet ndërkombëtar finalistësh na tregon edhe



një herë se letërsia e shkëlqyer nuk njeh kufij".

Çmimi Neustadt është i pari çmim ndërkombëtar për letërsinë i kësaj kategorie, që e ka origjinën në Shtetet e Bashkuara dhe është një nga të paktat çmime ndërkombëtare për të cilat kanë të drejtë të konkurrojnë njëkohësisht poetë, romancierë, skenaristë dhe dramaturgë. Që prej vitit 2003, duke u alternuar me Çmimin NSK, ky çmim i është dhënë çdo dy vjet një shkrimtari të gjallë, si vlerësim për një vepër të rëndësishme. Fitues të kaluar janë edhe laureatët e Çmimit Nobel, si Czesław Miłosz, Gabriel García Márquez dhe Tomas Tranströmer. Fituesi i Çmimit Neustadt për vitin 2018 ishte shkrimtari amerikan me origjinë nga Haiti, Edwidge Danticat. Fituesi i Neustadt Prize shpërblehet me $50.000, një pupël shqiponje prej argjendi, certifikatën e çmimit dhe një festival në nder të tyre. Një financim bujar nga familja Neustadt mbështet çmimin.

BESNIK MUSTAFAJ NDEROHET ME ÇMIMIN PRESTIGJIOZ "FLAIANO LITERARY" NË ITALI

Shkrimtari shqiptar Besnik Mustafaj ishte mysafir nderi në edicionin e 46-të të ndarjes së çmimit "Flaiano Literary", mbi krijimet në italisht, një event ndërkombëtar që vlerëson shkrimtarët. Një pjesë e rëndësishme e ngjarjes ceremoniale, mbajtur në Pescara, ishte e dedikuar për promovimin e romanit të tij *Piccola saga carceraria*. Një vit pas botimit të tij, romani vazhdon të ketë një jehonë të rëndësishme në media, si dhe është mirëpritur ngrohtësisht nga kritikët italianë. Libri trajton temat e historisë së re të Shqipërisë, kulturës dhe letërsisë shqiptare. Besnik Mustafaj bisedoi aty edhe me gazetarin e RAI-t, Lucio Valentini. Presidentja e çmimit "Flaiano", Carla Tiboni, i dha shkrimtarit shqiptar çmimin "Flaiano Literary" me motivacionin "Për aktivitetet ndaj promovimit kulturor në integrimin Adriatik-Jon-Mesdhetar".

FESTIVALI PRIFEST: IRENA CAHANI DHE ARBEN BAJRAKTARAJ, AKTORJA DHE AKTORI MË I MIRË

Në ceremoninë përmbyllëse të edicionit të 11-të të PriFest janë ndarë çmimet në kategoritë kryesore për filmat pjesëmarrës.

Çmimi për regjisorin më të mirë nga PriFest iu dha Mahmut Fazil Coskun-it, për filmin *Njoftimi*; çmimi për aktoren më të mirë iu dha Irena Cahanit në filmin *Streha mes reve*; çmimi për aktorin më të mirë iu dha Arben Bajraktarajt në filmin *Streha mes reve*; çmimi për arritje jetësore nga PriFest iu dhurua Melihate Qenës dhe Selman Lokës; çmimi për filmin më të mirë europian iu dhurua *Pasojat*, me regji të Darko Stante-s nga Sllovenia; çmimin për dokumentarin më të mirë e fitoi Rodrigo Areias, *Frymëmarrja blu*, nga Portugalia.

Fituesi i programit të konkurrencës së mesme është *Lëre vdekjen të jetë e gjallë* nga Uriel Jaouen Zrehn nga Franca. Fituesi i çmimit të jurisë FIPRESCI është *The Announcment* nga Mahmut Fazil Coskun nga Turqia. Fituesi i filmit më të mirë të studentëve është *Kafazi i ngjyrave* nga Daniel Reascos nga Ekuadori. Fituesi i çmimit të Jurisë së Mediave është Carlos Marques-Marcet, *Ditët për të ardhur*, nga Spanja. Ndërsa Juria e Studentëve të Pavarur ka zgjedhur filmin *Let's the death be alive*, nga Uriel Jaouen Zahern. Çmimi në vlerë prej 1500 eurosh nga PriFest i është dhënë Julian Malajt dhe Harris Davis-it për filmin *Vëllai im*. Çmimi për Sound Post Production, në vlerë prej 10.000 eurosh, i dhuruar nga Audiohaus, ka shkuar për *Aisha* të Hanis Bagashov-it. Çmimi Video Post Production, në vlerë prej 50.000 eurosh, i dhuruar nga In My Country Production, ka shkuar për *Gulizar* të Belkiz Bayrak-ut. Çmimi për fituesin e çmimit *Green Film* është *Nature* nga Beatrice Shabanaj dhe Verona Berisha.

JONATHAN FRANZEN

S'DO TË DOJA TË SHKRUAJA GJËRA QË S'JANË LETËRSI

Intervistoi: Isaac Chotiner

A keni menduar ndonjëherë të shkruani një libër për racizmin?
E kam menduar, por është rrëfim që më vë në siklet ta bëj, s'kam asnjë mik me ngjyrë. S'jam dashuruar ndonjëherë me një vajzë me ngjyrë. Po të kishte ndodhur, do të kisha guxuar të shkruaja.

Po thoni që s'jeni dashuruar asnjëherë me një zezake?
Ashtu është. Gruan s'e kam me ngjyrë. Unë shkruaj për personazhe dhe duhet ta dua një personazh në mënyrë që të shkruaj për të. Nëse s'ke pasur përvojë vetjake ta duash një kategori individësh, një njeri të një race tjetër, një njeri shumë fetar, dikë që mbart cilësi që përbëjnë dallime të mëdha mes njerëzve, mendoj se është e vështirë të guxosh apo madje të duash të shkruash, të hysh plotësisht në brendësi të këtij personi. Në rastin e romanit *Dëlirësia*, kisha shumë material që lidhej me Gjermaninë. Kisha kaluar dy vjet e gjysmë atje. E njihja letërsinë gjermane mirë, por s'shkruaja dot për Gjermaninë, sepse s'kisha asnjë mik gjerman. Mundësia e vetme për të qenë në gjendje të shkruaja për të ishte fakti që befas zura miqësi me miq gjerman të cilët i doja me të vërtetë. Pas kësaj nuk isha një i huaj armiqësor, por një i familjes dhe miqësor.

Por, megjithatë, ka personazhe në romanet tuaja të cilët nuk të bëjnë fare t'i duash.
Eh, po si e përkufizon ti dashurinë?

Epo, realisht po mendoja, çfarë ju kuptoni me dashuri?
Bëj të pamundurën të mos dëgjoj atë që njerëzit thonë për mua. Në fillim të romanit kjo ide i vjen Edlirës dhe ajo fillon bën një listë të gjërave që përbënin dashurinë për nënën e saj. Ndiente keqardhje, vuante për të, ndiente një tërheqje trazuese ndaj trupit të saj, dëshironte që ajo të ishte e lumtur, ishte e shtrenjtë për të. Mendoj se ka të bëjë me të pranuarit që një njeri tjetër është i tillë dhe ta kuptosh këtë plotësisht. Dhe të duash të jesh me këtë person, të të pëlqejë të jesh me këtë person pavarësisht nga të metat. Kështu, ashtu si te romani *Dëlirësia*, Andrea ka disa tipare të papëlqyeshme, por për shkak se ka pasur një fëmijëri të trazuar dhe për shkak se është përballur gjatë gjithë jetës me sëmundjen e tij mendore dhe meqenëse unë kam njohur njerëz të tillë ndërkohë që ai s'ishte thjesht një njeri i keq, luftonte pareshtur për t'u bërë njeri më i mirë. Mua më prekte kjo dëshirë e tij, e cila mendoj se është dëshirë e vërtetë, të duash të jesh njeri më i mirë. Kjo ishte pika e lidhjes sime me të. Pavarësisht nga ajo që bën, ai është i vetëdijshëm për atë që po bën, mendon për këtë dhe përpiqet të jetë i ndershëm. Ka edhe tipare të mira. Dhe gjithashtu, dashuria e madhe është pjesë e identitetit. Dhe identiteti im përbëhet nga shumë pjesë. Dhe jo për të gjitha këto pjesë do të doja të shkruaja, gjëra që s'janë letërsi.

Kjo intervistë është vendi për ta bërë.
Pikërisht. E di si është kjo paranojë. E di se çfarë do të thotë të shqetësohesh për atë që njerëzit po thonë dhe të fiksohesh me atë që po thonë për ty. Të gjitha këto gjëra Andreas i përjeton, ndërsa fama e tij është më e madhe se e çdo shkrimtari, por disa gjëra në lidhje me famën i kam mësuar nga përvoja ta tilla.

A ka ndonjë shkrimtar që e keni zili?
Nuk e ndiej këtë shumë, por tani jam dikushi. Në një univers të përfytyruar me shkrimtarë, çdo dy vjet, tre vjet, katër vjet, i gjithë vendi duhet të mbajë shënim se çfarë po shkruan dhe t'i kushtojë vëmendje për disa muaj librit të ri të shkrimtarit. Dhe duhet të shkruhen shkrime kritike kudo, duhet të ketë shtëpi plot me njerëz që duan të dëgjojnë për çfarë ka shkruar dhe libri i tij duhet të qëndrojë në krye të listës së librave më të shitur



“

Në rastin e romanit Dëlirësia, kisha shumë material që lidhej me Gjermaninë. Kisha kaluar dy vjet e gjysmë atje. E njihja letërsinë gjermane mirë, por s'shkruaja dot për Gjermaninë, sepse s'kisha asnjë mik gjerman.

Jonathan Franzen është ndër shkrimtarët më të njohur bashkëkohorë amerikanë. Autor i pesë romaneve, pesë librave joletrarë dhe dhjetëra tregimeve dhe eseve. Me romanin e tij të tretë 'Korrigjimet" (2001), Franzen fitoi Çmimin Kombëtar të Librit. Romani "Liria" (2010) u vlerësua gjithashtu duke u nxjerrë në kopertinën e revistës "Times" me titullin "Shkrimtar i madh amerikan". Dëlirësia" (2015) është romani më i fundit, ndërkohë që shkruan vazhdimisht për revistën "The New Yorker".

për vite me radhë dhe pastaj të gjithë duhet të bien në qetësi derisa të botohet libri tjetër. Kështu, pavarësisht se sa mirë po shkruan, nëse nuk boton një libër, kur sheh që dikush tjetër po tërheq vëmendjen, është një pjesë e vogël jotja që të thotë: "Pse po i kushtojnë vëmendje këtij njeriu? A e kanë lexuar të gjithë librin tim?" Është marrëzi. Marrëzi e vërtetë. Është ajo që shkrimtari në fshehtësi do. Mua s'më pëlqen ndjenja e vlerësimit të tepërt, megjithatë e kap veten duke menduar: "Epo unë nuk e mora këtë çmim. Kujt iu dha?" Nuk është zili, por në imagjinatën e shkrimtarit, kur fiton dikush, humbet dikush tjetër. Çdo gjë që merr dikush, të duket sikur po ta marrin ty. Është mirë të tregohesh racional për këtë dhe të thuash: "Është marrëzi ta mendosh kështu. Është hapësirë e madhe, ka vend për të gjithë ne." Por s'jam i sigurt. Mbase s'është ndjenjë universale. Mbase unë jam njeri i keq.

Sidoqoftë, jam i sigurt që kjo ndjenjë mbizotëron edhe në profesione të tjera.

Por shkrimtari në veçanti, e ndien më shumë. Shkrimtari e ndien sidomos për shkak se krijon nga hiçi. Ti si shkrimtar as që ke një vegël tënden, ke vetëm egon tënde të vogël që të bën të dukshëm dhe të pambrojtur, pa dikë që i bie trumbetës apo basit për të tërhequr vëmendjen e ti të fshihesh. Mund të zgjedhësh çdolloj fjale, sipas çdolloj rendi, nuk ka rregulla për këtë. Pra, ajo që ti nxjerr nga vetja s'ka emër kur del dhe thjesht ti je autori. Është shprehje e asaj që ti je. Dhe mendoj se egoja e shkrimtarit përballet në mënyrë unike me përmasat e realitetit.

Si e gjeni ekuilibrin mes dëshirës për të mos dëgjuar kritika në median sociale dhe faktit se janë çështje që lidhen me internetin dhe demokracinë, çështje të rëndësishme, dhe ma merr mendja që doni të shpreheni për to. Për të kuptuar median sociale, a duhet të bëhesh pjesë e saj? Sepse besoj që ju s'e kaloni gjithë ditën në Twitter.

Jo, s'e kaloj gjithë ditën në Twitter. Ndjenja që unë provoj buron nga përvoja ime si shkrimtar, e cila më shtyn të mendoj se është më mirë të mos dish tepër për diçka. Bëhu pjesë e diçkaje, provoje, ndiq intuitën tënde, atë që po të tregon instinkti për atë që po vëzhgon. Pastaj shkëputu dhe mendo me të vërtetë për këtë dhe përdor imagjinatën. Kështu, komedia "Silicon Valley" na shpie tek instinkti primitiv që më tregon se kjo teknologji s'para duket se i ka çliruar njerëzit. Duket sikur njerëzit po sillen vërdallë të skllavëruar nga smartfonat. Kjo është ajo që shohim për sa i përket sjelljes. "Mendoj se është vërtet e rrezikshme, nëse jeni një amerikan i bardhë liberal, të mendosh që qëllimet e tua të mira mjaftojnë për të nisur të shkruash një vepër letrare për zezakët e Amerikës". Kam ndjekur një kolegj të arteve liberale ku vlerësoheshe nëse flisje me kompetencë për gjërat që lexoje, për një kapitull libri që lexohej me nxitim një natë para provimit. Por si shkrimtar veprash letrare, nëse u kushton me të vërtetë shumë vëmendje gjërave të vogla, mund të marrësh shumë nga ato. Një përvojë e përjetuar fort mund t'i tregojë shumë një shkrimtari.

A ka ndonjë kundërthënie mes kësaj dhe asaj që thatë më lart për ndjenjën e pamundësisë për të shkruar për racën për shkak të mungesës së përvojës?

Jo, po flisnim për dashurinë. Për dashurinë. Pra, thashë se është vërtet e rrezikshme, nëse je amerikan i bardhë liberal mendon se qëllimet e mira për të shkruar një vepër letrare për zezakët e Amerikës mjaftojnë. Këtë dua ta theksoj fort. Kam menduar shumë për këtë, sepse çështja e racës është shumë e rëndësishme në Amerikë.

A keni menduar të shkruani një libër më të shkurtër ose tregime. Librat tuaj të fundit kanë qenë voluminozë.

Të gjitha romanet e mia kanë qenë të së njëjtës madhësi, rreth 530, 540 faqe. Kjo është madhësia e librave të mi. Vë re që më nxisin të shkruaj një roman të shkurtër që të mund të studiohet në shkollat e mesme, sepse kështu agjencia letrare fiton më shumë para të cilat mund të dhurohen për ruajtjen e zogjve.

Si do t'i përkufizonit librat që shkruani?

Epo, ato s'janë romane politike. Kjo është e sigurt.

S'mendoni se librat tuaj janë politikë? Nuk janë si romani "Këshillë dhe kënaqësi" i Allen Drury-t, një roman për politikën e Uashingtonit, por ato janë politikë apo jo?

Janë të vetëdijshëm për politikën, por nuk mbështesin ndonjë çështje politike. Dhe nuk kërkojnë të kesh pikëpamjet e shkrimtarit që t'i pëlqesh librat.

Cila është rutina e të shkruarit kur jeni duke shkruar një libër?

Shumë rrallë më ndodh të kem një rutinë të shkruari. Do të kisha shumë dëshirë të shkruaja gjatë gjithë kohës, por këto ditë janë në mënyrë tragjike kaq të pakta. Rutina që ndiqja kur shkruaja artikullin e botuar së fundi, një shkrim për Antarktidën i botuar në *New Yorker*: zgjohesha në tetë të mëngjesit dhe haja mëngjes, lexoja *New York Times* të cilën e lexoj akoma. Pastaj udhëtoja me makinë për dhjetë minuta për të shkuar te zyra ime. Është një dhomë e vogël, e errët, e ftohtë, e qetë dhe punoj në mënyrë ideale për gjashtë orë, gjatë të cilave përpiqem të shkruaj një mijë fjalë. Pastaj kthehem në shtëpi dhe dy orë i kaloj duke u marrë me e-mailin. Më pas shkoj në palestër, ose luaj tenis, pi diçka. Kathy vjen në shtëpi pasi i ka bërë një vizitë së ëmës. Hamë darkë, shohim televizion, lexojmë diçka. Këto ishin ditë të lumtura.

Sa angazhoheni me kulturën popullore? A s'ndieni se duhet ta bëni, përderisa shkruani libra të rëndësishëm për Amerikën?

Jo, jam dembel. S'më pëlqen të bëj kërkime për librat. Nganjëherë e detyroj veten me forcë të bëj kërkime kur s'di asgjë për temën, por ideja e ekspozimit ndaj gjërave vetëm për të grumbulluar përshtypje më duket se s'është punë për një romancier të vërtetë, sepse unë s'jam nga ata që dalin në rrugë me libër shënimesh në dorë. S'dua të ndodhem në situata të vështira, ndërsa përpiqem të gjej material që mund ta përdor për shkrimet. Jo, kultura popullore që konsumoj është vetëm ajo që më pëlqen. Kështu di shumë gjëra për Ligën Kombëtare të Futbollit (LKF), sepse, më duhet ta pranoj me keqardhje, vazhdoj ta pëlqej shumë të parit e ndeshjeve të futbollit të LKF.

Përktheu: Granit Zela

Onufri

SUPER OFERTË VERORE!

3 Libra për ~~2100~~ 1800 Lekë + 1 falas



Telefononi në: 067 63 75 778

Jua sjellim për 24 orë, kudo që të ndodheni në Tiranë

për vetëm 1800 Lekë
pasuroni bibliotekën tuaj
me 4 libra nga autorë
të shquar botërorë